REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL



# RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

## Janar - Dhjetor 2025

Prishtinë, mars 2026.

+383 (0) 38 200 64 209
mapl.rks-gov.net
Ish ndërtesa Rilindja
Kati: 11, 12 dhe 13 Prishtinë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

# RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky raport paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës, në të cilin përfshihen: *funksionimi i kuvendeve dhe ekzekutivit të komunës*; *transparenca komunale*; *zbatimi i obligimeve të komunave që rrjedhin nga Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit*; Gjithashtu, raporti trajton planifikimin, realizimin dhe shpenzimin e buxhetit komunal, si dhe jep një pasqyrë të opinioneve të auditorit të përgjithshëm për komunat për vitin paraprak.

Prishtinë, 2026

Raporti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

# PËRMBAJTJA

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ................. 1
SHKURTESAT ............................................................................................................ 3
HYRJE ...................................................................................................................... 4
METODOLOGJIA ...................................................................................................... 5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ................................................................................. 6
FUNKSIONIMI I KOMUNAVE ................................................................................... 8
KUVENDI I KOMUNËS ............................................................................................. 9
KOMITETET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE ....................................................... 10
KOMITETET NDIHMËSE DHE KOMITETET KONSULTATIVE ................................ 11
AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE ................................................................ 12
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA KOMUNALE .......................................... 13
Ueb-faqet zyrtare të komunave ...................................................................... 15
SIGURIA NË BASHKËSI .................................................................................. 17
MBIKËQYRJA E KOMUNAVE .......................................................................... 19
PROCEDURA E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM ............................................... 19
SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË KOMUNAVE NGA MAPL ........... 20
SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË KOMUNAVE NGA MINISTRITË E LINJËS ......21
AGJENDA EVROPIANE ........................................................................................... 22
KRITERET POLITIKE ........................................................................................ 23
KRITERET EKONOMIKE ................................................................................... 28
STANDARDET EVROPIANE .............................................................................. 30
FINANCAT LOKALE ................................................................................................ 38
PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE ........................................................... 38
REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE .............................................................. 38
BUXHETIMI KOMUNAL PËR VITIN 2025 .......................................................... 46
RAPORT LIDHUR ME OPINIONET E AUDITIMIT PËR KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ................................................................................................................ 50
GJETJET KRYESORE TË AUDITIMIT .............................................................. 51
REKOMANDIMET ................................................................................................... 52

# SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| **AE** | Agjenda Evropiane |
| **AKP** | Agjencia Kosovare e Privatizimit |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **EVS** | Ekipet Vepruese për Siguri |
| **KK** | Kuvendi Komunal |
| **KKSB** | Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi |
| **KLSP** | Këshilli Lokal për Siguri Publike |
| **LFPL** | Ligji për Financat e Pushtetit Lokal |
| **LVL** | Ligji për Vetëqeverisje Lokale |
| **MD** | Ministria e Drejtësisë |
| **MF** | Ministria e Financave |
| **ML** | Ministritë e Linjës |
| **MPB** | Ministria e Punëve të Brendshme |
| **MAPL** | Ministria e Pushtetit Lokal |
| **MSA** | Marrëveshja e Stabilizim Asociimit |
| **OKB** | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| **OJQ** | Organizatat Jo-Qeveritare |
| **PKZMSA** | Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit |
| **PL** | Pushteti Lokal |
| **PQ** | Pushteti Qendror |
| **PRE** | Programi për Reformë Ekonomike |
| **SIMFK** | Sistemi Informativ i Menaxhimit Financave të Kosovës |
| **SVL** | Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026 |
| **UA** | Udhëzim Administrativ |

# HYRJE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, gjatë vitit 2025 është përkushtuar në zbatimin e prioriteteve të saja strategjike në funksion të mbështetjes dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Në vitin 2016 ka hyrë në fuqi Strategjia dhjetëvjeçare për Vetëqeverisje Lokale (2016 – 2026), e cila ofron një vizion të qartë për ecurinë e reformës dhe zhvillimit të pushtetit lokal. Në përputhje me objektivat zhvillimore të saj, janë operacionalizuar aktivitetet dhe janë përcaktuar një sërë masash të kërkuara veçanërisht nga pushteti lokal. Shtyllë kryesore e synuar mbetet qeverisja e mirë në nivel lokal, transparenca komunale, mbikëqyrja dhe kontrolli i ligjshmërisë, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve dhe prioritizimi i obligimeve të komunave nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, për të cilat MAPL është duke punuar ngushtë me nivelin lokal, partnerët, shoqërinë civile dhe akterët tjerë.

Raporti për funksionimin e komunave është dokument që vlerëson progresin e komunave gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025. Ky raport hartohet çdo vit deri me datë 31 Mars dhe i njëjti paraqitet para Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij raporti është të informohen drejtë: Qeveria, Kuvendi i Republikës së Kosovës, komunat, shoqëria civile, qytetarët dhe grupet e tjera të interesit, lidhur me funksionimin dhe shkallën e arritshmërisë së progresit të komunave, por edhe sfidave të hasura gjatë vitit. Raporti ofron konkluzionet lidhur me fushat përkatëse dhe jep rekomandimet specifike për komunat që duhet adresuar në të ardhmen.

Raporti ka këtë strukturë, si vijon:

- Përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Paraqet rezultatet e punës së organeve komunale, me theks të veçantë kuvendit të komunës si organi më i lartë në komunë;
- Analizon fushën e transparencës komunale;
- Shqyrton hapat e komunave në zbatimin e obligimeve nga Programi Kombëtar për MSA;
- Paraqet të dhënat për planifikimin e buxheteve komunale, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet buxhetore;
- Jep një pasqyrë të opinioneve të auditorit të përgjithshëm për komunat për vitin paraprak.

# METODOLOGJIA

Ky raport është hartuar mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe të analizuara gjatë procesit të monitorimit të komunave nga departamentet dhe njësitë përgjegjëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Të dhënat e përfshira në raport pasqyrojnë gjendjen dhe funksionimin e komunave gjatë vitit 2025, duke u mbështetur në informacionet e siguruara nga institucionet përkatëse dhe nga procesi i rregullt i monitorimit institucional.

Në kuadër të përgatitjes së raportit janë përdorur burime të ndryshme të të dhënave. Informacionet janë siguruar nga zyrtarët komunal, si dhe nga monitoruesit e MAPL-së përmes aktiviteteve të tyre në terren. Këto të dhëna janë plotësuar me informata shtesë të mbledhura gjatë procesit të monitorimit të drejtpërdrejtë të komunave dhe nga dokumentacioni zyrtar i institucioneve përkatëse.

Një pjesë e rëndësishme e të dhënave është marrë nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) dhe nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave, (MF). Gjithashtu, janë shfrytëzuar raportet që lidhen me obligimet e komunave në kuadër të agjendës evropiane, si dhe të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve të përgatitur për fushat specifike të trajtuara në këtë raport.

Metodologjia e përdorur në hartimin e raportit është përshkruese dhe analitike. Përmes kësaj qasjeje janë analizuar të dhënat e mbledhura për të paraqitur një pasqyrë të qartë të funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2025, duke identifikuar zhvillimet kryesore dhe nivelin e zbatimit të përgjegjësive institucionale në nivel lokal.

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 430 mbledhje, prej te cilave, të rregullta kanë qenë 325, të jashtëzakonshme 43, solemne 55 dhe urgjente 7. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë të hapura për publikun, duke u dhënë mundësinë qytetarëve të informohen rregullisht për zhvillimet e politikave lokale, njëkohësisht ato janë transmetuar edhe në ueb faqet zyrtare të komunave përmes kanalit të youtube. Paralelisht me kuvendet, aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar edhe komitetet obligative, si dhe komitetet e tjera të themeluara. Sipas të dhënave, janë mbajtur 338 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 321 të Komitetit për Komunitete. Krahas kësaj, gjatë vitit 2025, 3 komuna kanë themeluar komitetet e tjera në 11 fusha përkatëse, si dhe 3 komuna kanë themeluar komitete konsultative, në 5 fusha përkatëse.

Për nga numri i akteve të kuvendeve, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 1478 akte, prej të cilave janë 54 rregullore dhe 1424 vendime. Kuvendi i Komunës që ka miratuar më së shumti akte është Kuvendi i Komunës së Kamenicës, 128 akte, e pasuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut me 77 akte, pasuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt me nga 75 akte, ndërsa me numrin më të vogël të akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe të raportimit ka qenë Kuvendi i Komunës së Leposaviqit me 7 akte. Kuvendet e komunave kanë ushtruar rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit të komunës. Në 34 komuna kryetarët e komunave kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor për të raportuar para kuvendit të komunës, madje në 6 komuna, kryetarët kanë raportuar më shumë se dy herë. Në 1 komunë, kryetari nuk ka përmbushur obligimin ligjor për raportim, pasi ka raportuar vetëm 1 herë brenda vitit, ndërsa në 3 komuna (Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq), kryetarët nuk kanë raportuar fare.

Promovimi i transparencës komunale mbetet një nga çështjet kyçe të qeverisjes demokratike. Gjithsej 38 Komuna kanë përmbushur obligimet ligjore për të mbajtur së paku 2 takime me qytetarët, 21 kanë publikuar ftesat për takime publike me qytetarët, 3 komuna kanë publikuar njoftime për një takim, ndërsa 14 komuna nuk kanë përmbushur obligimin ligjor për publikimin e ftesave për takimet publike me qytetarët.

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku sipas të dhënave në 30 komuna numri i grave në pozita menaxheriale është 755. Krahas tyre, në administratën publike lokale duke përfshirë edhe kuvendin e komunës në 30 komuna numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike është gjithsej 7397. Sa i përket raportit statistikor (gjinor) të drejtorëve të drejtorive komunale, në 27 komuna janë 85 drejtoresha. Megjithatë, ka nevojë të ngritët vetëdija e përgjithshme institucionale dhe shoqërore, ashtu që të adresohet edhe një nga rekomandimet kryesore të BE-së për përfshirje të grave në pozita vendimmarrëse.

Siguria në bashkësi mbetet përgjegjësi e përbashkët institucionale me qëllim të uljes së rreziqeve ndaj jetës dhe sigurisë së qytetarëve. Kufijtë e mbrojtjes policore nuk mjaftojnë për t'u përballur me fenomenet sociale të shumta që mund të ndodhin në bashkësi, për çfarë kërkohet bashkëpunim dhe bashkërendim i të gjitha mekanizmave, përfshirë: komunat, policinë, akterët e shoqërisë civile,

qytetarët, mediet, etj. Për këtë arsye, këshillat për siguri në bashkësi janë forume të cilat mund të sjellin ndryshime esenciale në politikat e sigurisë në bashkësi dhe në përcaktimin e prioriteteve në këtë fushë. Vetëm 5 komuna kanë përmbushur kuotën ligjore për të mbajtur se paku 6 takime në vit. Komuna e Shtimes ka tejkaluar këtë kuotë me gjithsej 8 takime, ndërsa komunat Kaçanik, Hani i Elezit, Istog dhe Dragash kanë mbajtur nga 6 takime secila. Ndërsa komunat që nuk e kanë përmbushur kuotën ligjore por kanë mbajtur takime janë si vijon: Komunat Suharekë, Rahovec, Vushtrri, Pejë dhe Skenderaj nuk e kanë përmbushur kuotën ligjore, por kanë qenë afër saj, duke mbajtur nga 5 takime. Komunat që kanë mbajtur nga 4 takime janë: Gjilan, Deçan, Prishtinë dhe Mitrovicë e Jugut. Ndërsa nga 3 takime kanë mbajtur komunat: Junik, Klinë, Viti, Malishevë, Obiliq, Gllogoc, Prizren dhe Zubin Potok. Me nga 2 takime janë: Ranillugu, Graçanica, Kllokoti, Kamenica, Lipjani, Novobërda dhe Podujeva. Vetëm nga 1 takim kanë mbajtur Parteshi dhe Fushë Kosova. Ndërkohë që në komunat Ferizaj, Mitrovicë e Veriut, Mamushë, Shtërpcë, Gjakovë, Zveçan dhe Leposaviq nuk është mbajtur asnjë takim gjatë periudhës raportuese.

Gjatë vitit 2025, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej 1478 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (54 rregullore dhe 1424 vendime). Nga gjithsej 1478 akte te miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 699 akteve, ndërsa 779 akte janë shqyrtuara nga ministritë e linjës.

Kosova është duke kaluar nëpër një stad të rëndësishëm të zhvillimeve dhe ndërtimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. Marrëveshja për Stabilizim Asociim e nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe BE ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016, derisa Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, i cili përbën dokumentin kryesor nacional të politikave për aderim në BE. Komunat si aktor të rëndësishëm shtetëror kanë barrën e tyre të përgjegjësisë në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kritereve kryesore të integrimit: a) Politike, b) Ekonomike, c) Standardeve Evropiane. Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2025 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 64% të aktiviteteve në fushën e kritereve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 71% të kritereve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 65% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2025 është 67%.

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2025 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 837,642,279.69 € ose 96.92% e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 864,227,543.13 €. Për vitin 2025, realizimi i të hyrave për vitin 2025, prej 121,572,826.59€, krahasuar me planifikimin prej 114,283,838.00€, ka një tejkalim të planit prej 6.38 %, krahasuar me vitin 2024 që realizimi nuk kishte arritur planin vjetor për (- 5.63%).

# FUNKSIONIMI I KOMUNAVE

Ky raport paraqet një pasqyrë të funksionimit të organeve të komunave në Republikën e Kosovës në përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacioni përkatës në fuqi, të cilat përcaktojnë kompetencat e vetëqeverisje lokale. Qëllimi i raportit është të vlerësojë mënyrën e ushtrimit të kompetencave nga autoritetet komunale dhe të evidentojë nivelin e zbatimit të parimeve të qeverisjes lokale, duke përfshirë përgjegjshmërinë, qëndrueshmërinë e organeve komunale, transparencën dhe respektimin e ligjshmërisë në proceset vendimmarrëse në nivel komunal.

Në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi, komunat përbëjnë njësinë themelore të vetëqeverisjes lokale dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e një pjese substanciale të çështjeve publike në interes të qytetarëve të tyre. Organizimi dhe funksionimi i organeve komunale, në veçanti i kuvendit të komunës dhe i kryetarit të komunës, bazohet në parimet e përcaktuara nga ligji, të cilat synojnë sigurimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm të qeverisjes lokale.

Në këtë kuadër, monitorimi i funksionimit të kuvendeve të komunave paraqet një element kyç për garantimin e funksionimit demokratik të institucioneve lokale. Kuvendi i komunës, si organi më i lartë përfaqësues në nivel lokal, ka rol thelbësor në miratimin e akteve komunale, mbikëqyrjen e ekzekutivit komunal dhe sigurimin e përfaqësimit të interesave të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Funksionimi efektiv i këtij organi kontribuon në respektimin e procedurave ligjore dhe në forcimin e llogaridhënies institucionale.

Gjithashtu, raporti evidenton rëndësinë e respektimit të procedurave ligjore gjatë mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit, miratimit të vendimeve dhe ushtrimit të kompetencave komunale. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcakton qartë mënyrën e organizimit të mbledhjeve, kuorumin për vendimmarrje dhe transparencën e proceseve, duke kërkuar që aktivitetet e organeve komunale të zhvillohen në mënyrë të hapur dhe në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i funksionimit të organeve komunale është bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet strukturave të ndryshme institucionale brenda komunës. Përmes komiteteve të përhershme dhe mekanizmave të tjerë institucionalë, sigurohet mbikëqyrja e politikave komunale, shqyrtimi i çështjeve financiare dhe adresimi i nevojave të komuniteteve. Këto mekanizma kontribuojnë në rritjen e efikasitetit institucional dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Në përfundim, funksionimi i organeve të komunave mbetet një element thelbësor për realizimin e parimeve të vetëqeverisjes lokale dhe për ofrimin e shërbimeve publike në nivel lokal. Respektimi i dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe promovimi i transparencës institucionale janë faktorë kyç për rritjen e efikasitetit të qeverisjes lokale dhe për avancimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve komunale.

# KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës në nivel të qeverisjes lokale dhe njëkohësisht mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kuvendi përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur dhe mban mbledhje të rregullta në mënyrë që të kryej funksionet e tij të përcaktuara me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe akte të tjera nënligjore.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar minimumin e mbledhjeve të cilat duhet ti mbaj kuvendi i komunës, brenda një viti. Ky ligj ka përcaktuar mbajtjen e së paku **10** mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, **5** prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.

Në Republikën e Kosovës në këtë periudhë kanë funksionuar kuvendet e **38** komunave, të cilat kanë mbajtur mbledhje rregullisht.

Gjatë këtij viti, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej **430** mbledhje. Prej tyre, të rregullta kanë qenë **325,** të jashtëzakonshme **43,** solemne **55** dhe urgjente **7**.

- ✓ Mbledhjet e rregullta, **325,**
- ✓ Mbledhjet e jashtëzakonshme, **43,**
- ✓ Mbledhjet solemne, **55,**
- ✓ Mbledhjet urgjente, **7.**

Mbledhjet e mbajtura kanë qenë të hapura për publikun, duke u dhënë mundësinë qytetarëve të informohen rregullisht për zhvillimet e politikave lokale, njëkohësisht ato janë transmetuar edhe në ueb faqet zyrtare të komunave përmes kanalit të youtube. Paralelisht me kuvendet, aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar edhe komitetet obligative, si dhe komitetet e tjera të themeluara. Sipas të dhënave, janë mbajtur **338** mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe **321** të Komitetit për Komunitete. Krahas kësaj, gjatë vitit 2025, **3** komuna kanë themeluar komitetet e tjera në **11** fusha përkatëse, si dhe **3** komuna kanë themeluar komitete konsultative, në **5** fusha përkatëse.

*Shtojca nr. 1 – Diagrami më numrin e mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave.*



Siç shihet edhe nga diagrami i paraqitur më lartë, shumica e komunave kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve të kuvendit të komunës, ashtu siç është përcaktuar më Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, komunat në përgjithësi kanë kryer obligimin ligjor në raport me MAPL-në si dhe me publikun, duke informuar ne vazhdimësi për mbajtjen e mbledhjeve, sipas afatit te përcaktuar ligjor, si dhe kanë dërguar edhe materialet për mbledhje, siç është përcaktuar me nenin 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Mbarëvajtja e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, gjatë kësaj periudhe ka qenë konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo janë evidentuar edhe raste kur një pjesë e anëtarëve të kuvendeve kanë lëshuar mbledhjet, ku janë ndërpre mbledhjet për shkak të mungesës së kuorumit në komunat:  Prishtinë, Dragash, Gjakovë, Gllogoc, Podujevë, Shtime, Kaçanik, Junik, Rahovec dhe Mitrovicë Veriore.

## KOMITETET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Bazuar në dispozitat e Ligji për Vetëqeverisje Lokale, kuvendet e komunave themelojnë dy komitete të përhershme: ***Komitetin për Politikë dhe Financa*** dhe ***Komitetin për Komunitete***. Anëtarët e komiteteve zgjedhën nga kuvendi dhe mandati i tyre është katër vjeçar. Këto komitete shërbejnë si mekanizma të rëndësishëm mbështetës për funksionimin e kuvendit të komunës, duke siguruar shqyrtim paraprak dhe trajtim më specifik të çështjeve që lidhen me kompetencat dhe përgjegjësitë e qeverisjes lokale.

Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga anëtarët e kuvendit të komunës dhe funksionon si organ këshillëdhënës i kuvendit. Në kuadër të mandatit të tij, ky komitet shqyrton paraprakisht të gjitha çështjet me karakter fiskal dhe financiar, përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën Afatmesme Buxhetore, projekt buxhetin vjetor, planin vjetor të prokurimit, rregulloret për tatimin në pronë, si dhe rregulloret që lidhen me tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale. Po ashtu, komiteti trajton edhe çështje të tjera që paraqiten për shqyrtim dhe miratim në kuvendin e komunës.

Komiteti për Komunitete përbëhet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të kuvendit të komunës, si dhe nga përfaqësues të komuniteteve që nuk janë të përfaqësuara në kuvend. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet së paku nga një anëtar në këtë komitet. Në përmbushje të rolit të tij, komiteti i rekomandon kuvendit të komunës masa dhe veprime konkrete për të siguruar zbatimin e dispozitave që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, si dhe për avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

Gjatë kësaj periudhe komitetet e përhershme kanë qenë funksionale dhe kanë mbajtur gjithsej **659** takime. Nga këto, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur **338** takime, ndërsa Komiteti për Komunitete **321** takime.

*Shtojca nr. 2 – Grafikoni më numrin e takimeve të mbajtura nga komitetet e përhershme të kuvendeve të komunave:*




Duke marrë parasysh se Komiteti për Politikë dhe Financa është organ i përhershëm i Kuvendit të Komunës, përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve dhe çështjeve të buxhetit, rrjedhimisht puna e këtij komiteti përfaqëson edhe rekomandimet për kuvendin e komunës. Mbi bazën e kësaj, ky komitet takimet duhet t'i mbajë para mbledhjeve të kuvendit të komunës, duke marrë parasysh funksionet e përcaktuara edhe me Rregulloret e Punës së Kuvendeve të Komunave.

Komiteti për Komunitete, është komiteti i dytë i përhershëm i kuvendit të komunës, detyrë e të cilit është shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ai gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

## KOMITETET NDIHMËSE DHE KOMITETET KONSULTATIVE

Në përputhje me nenin 73 të Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komuna, kuvendi i komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Këto komitete përbëhen nga qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe

shërbejnë si mekanizma konsultativë që kontribuojnë në adresimin e çështjeve me interes publik në sektorë të ndryshëm të zhvillimit lokal.

Komitetet konsultative kanë rol këshillëdhënës ndaj kuvendit të komunës dhe mund të dorëzojnë propozime, të realizojnë hulumtime si dhe të ofrojnë mendime lidhur me iniciativa dhe politika që shqyrtohen nga kuvendi. Aktiviteti i tyre zhvillohet në përputhje me statutin e komunës dhe synon të mbështesë procesin vendimmarrës në fusha specifike si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik lokal, shërbimet publike dhe sektorë të tjerë me rëndësi për komunitetin.

Sipas të dhënave për vitin 2025, vetëm **tri** komuna kanë themeluar komitete konsultative sektoriale. Këto komitete kanë funksionuar në pesë fusha kryesore, përkatësisht: arsim; kulturë, rini dhe sport; planifikim hapësinor; zhvillim ekonomik lokal; si dhe shëndetësi dhe mirëqenie sociale, duke përfshirë edhe çështjet që lidhen me shërbimet emergjente.

Sa i përket komiteteve të tjera ndihmëse, gjithashtu vetëm **tri** komuna kanë raportuar themelimin dhe funksionimin e tyre. Këto komitete kanë mbuluar gjithsej njëmbëdhjetë fusha të ndryshme sektoriale, duke përfshirë shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin, planifikimin hapësinor, bujqësinë, zhvillimin ekonomik dhe shërbimet publike, duke kontribuar në mbështetjen e punës së kuvendit të komunës në trajtimin e çështjeve specifike të zhvillimit lokal.

## AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Kompetencë dhe funksion themelor i kuvendit të komunës, është miratimi i politikave lokale përkatësisht i akteve nënligjore të komunës, si rregulloreve dhe vendimeve për zbatimin e legjislacionit sektorial që prek kompetencat e komunave. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, vendime, rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, Kornizën Afatmesme Buxhetore, miraton buxhetin, themelon komitetet, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës dhe nënkryetarët e komuniteteve, si dhe akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës.

Gjatë kësaj periudhe të gjitha kuvendet e komunave kanë qenë funksionale. Komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendit të komunës ka qenë i rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor.

Gjatë këtij viti, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsejte **1478** akte. Nga gjithsej **1478** akte të miratuara, prej tyre **54 janë rregullore**, dhe **1424 vendime**. Në vijim përmes grafikonit kemi paraqitur numrin e akteve të miratuara nga kuvendet e komunave:

*Shtojca nr. 3 – Grafikoni më numrin e akteve të miratuara nga kuvendet e komunave:*




Nga grafikoni nr. 3, vërejmë se në përgjithësi kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsejtë **1478** akte, prej të cilave **1424 vendime** dhe **54 rregullore**. Kuvendi i Komunës që ka miratuar më së shumti akte është Kuvendi i Komunës së Kamenicës, 128 akte, e pasuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut me 77 akte, pasuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt me nga 75 akte, ndërsa me numrin më të vogël të akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe të raportimit ka qenë Kuvendi i Komunës së Leposaviqit me 7 akte.

## TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA KOMUNALE

**Takimet publike me qytetarë të kryetarit të komunës -** Ligji për vetëqeverisje lokale, në kuadër të përgjegjësive të **kryetarit të komunës** ka përcaktuar obligimin për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në bazë të paragrafit j) të nenit 58 të këtij ligji, kryetari i komunës është i obliguar të raportojë para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Komunës. Të dhënat flasin se gjatë vitit 2025 numri i raportimeve të **34** kryetarëve të komunave para kuvendit ka qenë **76**, të cilat janë paraqitur, si vijon:

*Shtojca nr. 4 – Numri i raportimeve të kryetarëve para kuvendeve të komunave.*




Sipas diagramit më lartë në 34 komuna, kryetarët kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor për të raportuar para kuvendit të komunës, madje në 6 komuna, kryetarët kanë raportuar më shumë se dy herë. Në 1 komunë, kryetari nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor për raportim, pasi kanë raportuar vetëm nga 1 herë brenda vitit (Gjakovë). Ndërsa në 3 komuna, kryetarët nuk kanë raportuar fare (Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq).

Forma të tjera të llogaridhënies janë edhe përmes pyetjeve të drejtpërdrejta dhe me shkrim të parashtruara nga anëtarësia e kuvendit ndaj ekzekutivit. Për të mundësuar bashkëpunimin ndërmjet kuvendit dhe ekzekutivit të komunës, është i nevojshëm shtimi i prezencës së rregullt të kryetarëve dhe drejtorëve në mbledhjet e kuvendeve të tyre. Një komunikim i vazhdueshëm i të dy organeve i kontribuon demokracisë lokale, rritë cilësinë e vendimmarrjes dhe ligjshmërisë, zgjeron rrethin e aktorëve përgjegjës për hartimin e politikave të zbatueshme me interes të përgjithshëm, si dhe ndërton segmente të llogaridhënies brenda administratës komunale.

**Takimet publike me qytetarë** - Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion standarde të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 68.1, dhe udhëzimin administrativ Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, dhe atë përmes: takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik, përfshirjes aktive të qytetarëve, grupeve të interesit, tryezave të përbashkëta, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe metoda të tjera me të cilën transparenca do të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale çdo komunë mbanë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të merr pjesë secili qytetarë apo organizatë me interes në komunë. Njëra nga takimet duhet të mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të ngritin çështje të ndryshme dhe të japin propozime para organeve komunale. Në vitin 2025 gjithsej 38 komuna kanë përmbushur obligimet ligjore për të mbajtur së paku 2 takime në vit me qytetarët, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse lokale.

Përveç këtyre takimeve, komunat kanë mbajtur edhe takime të tjera me qytetarë në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit, janë bërë me rastin e diskutimit të projekt-rregulloreve, planeve dhe çështjeve buxhetore, të cilat qytetarëve u kanë mundësuar ofrimin e sugjerimeve, propozimeve dhe kërkesave të tyre.

Komunat pos takimeve publike me qytetar ashtu siç përcaktohet më nenin 68.1 kanë mbajtur edhe konsultime publike me qytetarë për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë më miratimin e rregulloreve komunale, planet zhvillimore, hartat zonale kornizën afatmesme buxhetore. Edhe pse komunat kanë organizuar konsultime publike me qytetarët, pjesëmarrja e tyre në këto takime ka qenë e vogël. Mbajtja e takimeve publike dhe formave të tjera të konsultimit publik duhet të jetë proces i vazhdueshëm në të gjitha fazat e politik-bërjes në komunë.

## Ueb-faqet zyrtare të komunave

Ueb-faqet zyrtare janë një nga mekanizmat kryesorë për të informuar qytetarët mbi aktivitetet e organeve komunale. Funksionimi i tyre rregullohet me **Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike**, i cili obligon institucionet publike të publikojnë:

- Informacione për punën e organeve dhe shërbimet e ofruara,
- Dokumente financiare, prokurimi dhe akte normative,
- Përgjegjësitë e njësive organizative dhe përmbajtjen e përditësuar të dokumenteve zyrtare.

Edhe pse më 1 mars 2025 u lansuan ueb-faqet e reja të komunave me synimin për të përmirësuar transparencën dhe qasjen në informata publike, monitorimi tregon se këto platforma ende përballen me mangësi në përditësimin e rregullt të përmbajtjes dhe në ofrimin e qasjes së shpejtë dhe të lehtë në të dhëna për qytetarët, duke kufizuar kështu efektivitetin e tyre në përmbushjen e nevojave për informim në kohë reale.

Sipas **Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale**, neni 58, kryetari i komunës është i obliguar të raportojë para kuvendit të komunës së paku njëherë në gjashtë muaj. Këto raporte publikohen në ueb-faqet zyrtare të komunës. Të dhënat e monitorimit për periudhën janar–dhjetor 2025 tregojnë se; **19** komuna (**50%**) kanë publikuar raportin e kryetarit, ndërsa **19** komunat e tjera (**50%**), nuk e kanë publikuar asnjë raport të kryetarit të komunës.

Sa i përket takimeve publike me qytetarë, çdo komunë duhet të mbajë së paku dy takime publike në vit, njëra prej të cilave gjatë gjashtëmujorit të parë. Takimet shërbejnë për informimin e qytetarëve mbi aktivitetet e komunës dhe marrjen e propozimeve dhe shqetësimeve nga qytetarët dhe organizatat me interes. Procesi i monitorimit në këtë fushë nxjerr të dhëna se; **21** komuna kanë publikuar njoftime për dy takime, **3** komuna kanë publikuar njoftime për një takim., dhe **14** komuna nuk kanë publikuar asnjë takim me qytetarë.

Rol të veçantë në transparencë dhe publikim të akteve janë publikimi i akteve të kuvendit të komunave. Komunat janë të detyruara të publikojnë të gjitha aktet normative të miratuara nga kuvendet e tyre, duke përmbushur obligimet që dalin nga **Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale**, **Rregullorja Nr. 02/2021**, si dhe **Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023**. Sipas të dhënave zyrtare për vitin 2025, numri total i akteve të miratuara është **1,203** akte nga **34** komuna.

Komunat që nuk kanë publikuar asnjë janë **4**.

Një nga aktivitetet kryesore të komunave mbetet edhe publikimi i akteve të kuvendeve komunale në përputhje me legjislacionin në fuqi; megjithatë, të dhënat tregojnë se nga **33** komuna kanë publikuar gjithsej **1,145** vendime, ndërsa **5** komuna nuk kanë publikuar asnjë vendim.

Përveç vendimeve, komunat gjatë vitit 2025, rezultojnë të kenë publikuar 58 rregullore të kuvendit të komunës në ueb-faqet e tyre zyrtare. **28 komuna** kanë arritur ti publikojnë rregulloret, ndërsa **10 komuna** të tjera nuk i kanë publikuar.

Tek pjesa e njoftimeve për mbledhjet e kuvendeve komunale, në periudhën Janar–Dhjetor 2025, janë publikuar **402** ftesa nga **33** komuna. **5** komuna nuk kanë publikuar asnjë ftesë.

Publikimi i procesverbaleve të Kuvendeve Komunale mbetet një tregues i rëndësishëm i transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal. Të dhënat tregojnë se janë publikuar gjithsej **299** procesverbale nga **30** komuna, ndërkohë që **8** komuna nuk kanë publikuar asnjë procesverbal. Sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa, janë publikuar **236** procesverbale nga **31** komuna, ndërsa, **7** komuna nuk kanë publikuar asnjë. Ky nivel publikimi tregon një angazhim relativisht më të lartë krahasuar me disa mekanizma të tjerë komunal. Në anën tjetër, Komiteti për Komunitete paraqitet me vetëm **101** procesverbale të publikuara nga **38** komuna, ku vetëm **20** komuna kanë publikuar procesverbale, ndërsa **18** të tjera nuk kanë publikuar asnjë.

Planifikimi dhe publikimi i buxhetit në komunë është një kusht kryesor për llogaridhënie dhe për të parandaluar keq-menaxhimin e fondeve publike. Publikimi i planit të buxhetit konsiderohet një nga kriteret kryesore të qeverisjes së mirë, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e organeve komunale ndaj qytetarëve. Sipas të dhënave për vitin 2025, shumica e komunave kanë bërë hapa drejt transparencës buxhetore, ku **26** komuna, ose rreth 68%, kanë publikuar planin e buxhetit, ndërsa **12** komuna, apo rreth 31%, nuk e kanë publikuar atë.

Publikimi i Planit të Prokurimit për periudhën janar–dhjetor 2025 përbën një obligim të qartë ligjor në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili kërkon që çdo autoritet kontraktues të hartojë dhe publikojë planifikimin paraprak të prokurimit me shkrim, së paku 60 ditë para fillimit të vitit fiskal. Ky plan duhet të përfshijë informata të detajuara mbi furnizimet, shërbimet dhe punët që planifikohen të realizohen gjatë vitit, duke shërbyer si instrument kyç për transparencë, planifikim efikas dhe llogaridhënie institucionale.

Megjithatë, të dhënat për vitin 2025 tregojnë një nivel të pjesshëm të zbatimit të këtij obligimi, ku **27** komuna (rreth 71%) kanë publikuar planin e prokurimit, ndërsa **11** komuna (rreth 29%) nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Kjo situatë evidenton përparim të moderuar, por njëkohësisht nxjerr në pah nevojën e vazhdueshme në sigurimin e transparencës së plotë në proceset e prokurimit publik.

Një instrument kyç për garantimin e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, janë edhe konsultimet publike. Publikimi i Planit të Konsultimeve Publike për periudhën janar–dhjetor 2025 përbën një obligim të rëndësishëm ligjor. Në përputhje me nenin 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, ky plan duhet të publikohet në

ueb-faqen zyrtare të komunës dhe të hartohet në fazat e hershme të planifikimit, përkatësisht gjatë përgatitjes së planit vjetor të punës dhe planit të komunikimit me publikun.

Megjithatë, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se vetëm **16** komuna (rreth 42.1%) kanë publikuar planin e konsultimeve publike. Në anën tjetër, shumica prej **22** komunash (rreth 57.9%) nuk e kanë publikuar këtë dokument, duke kufizuar mundësitë për informim dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Ky tregues reflekton mangësi të vazhdueshme në avancimin e transparencës dhe të qeverisjes së hapur në nivel lokal. Mungesa e publikimit të planeve të konsultimeve publike dobëson mekanizmat e dialogut ndërmjet komunave dhe qytetarëve, duke nënvizuar nevojën për forcimin e zbatimit të kornizës ligjore dhe për rritjen e angazhimit institucional ndaj praktikave gjithëpërfshirëse dhe transparente.

## SIGURIA NË BASHKËSI

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është organ këshillëdhënës ndër-sektorial që trajton çështjet e sigurisë në nivel lokal me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve të një komune dhe përfaqësues të shoqërisë. Funksionimi i këtyre këshillave rregullohet me Udhëzim Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për Këshillat Komunale për Siguri Në Bashkësi, i cili përcakton mënyrën e themelimit, përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi në secilën komunë të Republikës së Kosovës, si dhe rregullimi i mënyrës së funksionimit. Çdo komunë themelon KKSB-në, me vendim të Kuvendit Komunal të Komunës përkatëse. Përmes këtij mekanizmi institucional synohet koordinimi ndërmjet institucioneve lokale dhe aktorëve relevantë për adresimin e çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet.

Zbatimi i këtij udhëzimi administrativ ka kontribuar në rritjen e vetëdijes institucionale për rëndësinë e funksionimit të KKSB-ve. Si rezultat, komunat kanë rritur angazhimin e tyre në trajtimin e çështjeve të përgjithshme të sigurisë, duke përfshirë vetëdijesimin e qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitet. Po ashtu, përmes këtyre mekanizmave është mundësuar identifikimi i brengave të qytetarëve dhe përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre lidhur me çështjet e sigurisë dhe krimit në nivel lokal.

KKSB-të janë të themeluara në **31** komuna të Kosovës. Gjatë vitit **2025** janë mbajtur gjithsej **115** takime të këtyre këshillave, të cilat kanë shërbyer si platformë për diskutimin dhe adresimin e çështjeve të sigurisë në komunitet.

Në vijim, përmes grafikonit paraqitet shpërndarja e takimeve të KKSB-ve sipas komunave.

*Shtojca nr.5 – Numri i takimeve të KKSB-ve sipas komunave.*




Numri i përgjithshëm i takimeve të Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) në komunat e Kosovës është **115**. Nga këto, vetëm 5 komuna kanë përmbushur kuotën ligjore prej 6 takimesh në vit. Komuna e Shtimes ka tejkaluar këtë kuotë me gjithsej **8** takime, ndërsa komunat Kaçanik, Hani i Elezit, Istog dhe Dragash kanë mbajtur nga **6** takime secila. Komunat Suharekë, Rahovec, Vushtrri, Pejë dhe Skenderaj nuk e kanë përmbushur kuotën ligjore, por kanë qenë afër saj, duke mbajtur nga **5** takime. Komunat që kanë mbajtur nga **4** takime janë: Gjilan, Deçan, Prishtinë dhe Mitrovicë e Jugut. Ndërsa nga **3** takime kanë mbajtur komunat: Junik, Klinë, Viti, Malishevë, Obiliq, Gllogoc, Prizren dhe Zubin Potok. Me nga **2** takime janë: Ranillugu, Graçanica, Kllokoti, Kamenica, Lipjani, Novobërda dhe Podujeva. Vetëm nga **1** takim kanë mbajtur Parteshi dhe Fushë Kosova. Ndërkohë që në komunat Ferizaj, Mitrovicë e Veriut, Mamushë, Shtërpcë, Gjakovë, Zveçan dhe Leposaviq nuk është mbajtur asnjë takim gjatë periudhës raportuese.

Problemet më të shpeshta të cilat janë trajtuar gjatë kësaj periudhe të raportimit, si dhe iniciativat për realizimin e projekteve për siguri në bashkësi gjatë vitit 2025, janë: aksidentet në trafik; planet operative të ndërmarra nga Policia e Kosovës për ushtrimin e kontrollit më të rreptë të trafikut rrugor, për të zvogëluar aksidentet me fatalitet dhe sfidat; identifikimi i zonave të rrezikshme në trafik (ku ndodhin më shumë aksidente) si dhe përgatitja për pritjen e bashkatdhetarëve; çështjet e sigurisë në komunë; qentë endacak; infrastruktura; kontrolli i pyjeve; përgatitjet për fushatën e korrje - shirjeve në territorin e Komunës; fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera; zjarret në sezonin e verës; verifikimi i aparateve për fikjen e zjarreve; menaxhimi i situatës nga vërshimet e fundit dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera; ruajtja dhe mbrojtja e ambientit; situata në Komunë me ndriçim, parkingje, mbeturina dhe pastrim të rrugëve; siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme; abuzimi me fëmijë të moshës rinore dhe adoleshentë; bullizimi në shkolla; dhuna psiqike, fizike dhe seksuale në shkolla; trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra; e drejta për punë; puna në sektorin privat; orari i punës dhe kontratat e

punës; kthimi i  qytetarëve me banim të përkohshëm jashtë Kosovës, çështja e sigurisë dhe shërbimet Administrative.

## MBIKËQYRJA E KOMUNAVE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është autoriteti mbikëqyrës i komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme, ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar kompetencat.

Shqyrtimi administrativ është e drejta e institucioneve të nivelit qendror për ta shqyrtuar ligjshmërinë e akteve të komunave në veçanti aktet e miratuar në kuvendet e komunave por edhe aktet e miratuar nga kryetari i komunës në fushën e kompetencave vetanake, kompetencat e zgjeruara dhe përshtatshmërinë e aktiviteteve të tyre në fushën e kompetencave të deleguara.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe Ligji Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave i ka përcaktuar kushtet dhe procedurat se si niveli qendror (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokale dhe Ministrit Sektoriale) e ushtrojnë rolin e tyre mbikëqyrës.

## PROCEDURA E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Në rastet kur  Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrit Sektoriale konsiderojnë që një akt komunal nuk është në përputhje me ligjin në fuqi, ato mund të kërkojnë rishqyrtimin e aktit të tillë. Komuna do të duhej të përgjigjet në një kërkesë të tillë për rishqyrtim brenda **30** ditësh prej pranimit të saj. Nëse komuna e pranon kërkesën për rishqyrtim, ajo mund ta suspendojë ekzekutimin e vendimit apo aktit të kontestuar deri në shqyrtimin e mëtejshëm nga autoritetet lokale. Nëse komuna nuk përgjigjet brenda afatit të paraparë, refuzon kërkesën ose mbështet aktin apo vendimin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtojë aktin në fjalë në gjykatën kompetente brenda 30 ditësh prej dështimit për t'u përgjigjur. Gjykata mund të urdhërojë, si masë të përkohshme, suspendimin e zbatimit të vendimit apo aktit të kontestuar apo akteve tjera të përkohshme në pajtim me ligjin e zbatueshëm.

Shqyrtimi i ligjshmërisë përcakton të drejtën e MAPL-së dhe Ministrive sektoriale për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve të komunave, përfshirë:

- Statutet,
- Rregulloret e komunës,
- Vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës,
- Marrëveshjet për bashkëpunim ndër-komunal dhe komunal ndërkombëtar,
- Dokumentet e planifikimit hapësinor lokal Procedurat dhe kushtet e ushtrimit të këtij funksioni mbikëqyrës.

Në këtë raport janë përfshirë aktet e miratuara nga Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës si dhe vlerësimi i këtyre akteve nga MAPL dhe Ministritë e Linjës si dhe institucionet përgjegjëse për këtë proces.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për **38** komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti kërkesat për rishqyrtim, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

## SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË KOMUNAVE NGA MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ushtruar funksionin e saj mbikëqyrës përmes shqyrtimit sistematik të akteve të nxjerra nga komunat. Gjatë vitit 2025, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej **1,478** akte të aprovuara nga kuvendet e komunave. Nga gjithsej 1,478 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave, prej tyre **54** janë rregullore dhe **1,424** vendime.

MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e **699** akteve, apo **47.3%** e totalit. Në vijim, përmes diagramit kemi paraqitur të dhënat lidhur me procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL.

*Shtojca nr.6 – Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL.*




Në periudhë raportuese, siç shihet edhe nga diagrami i paraqitur më lartë, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e **699** akteve, ku **605** akte janë konfirmuar të ligjshme, që përbën **86.55%** e totalit. Rezultatet tregojnë një nivel relativisht të lartë të përputhshmërisë ligjore të akteve komunale, duke

reflektuar një funksionim të qëndrueshëm të mekanizmave të brendshëm institucional.

Ndërkohë, **94** akte, apo **13.44%,** janë identifikuar me mospërputhje dhe janë kthyer në rishqyrtim tek autoritetet komunale.

Sa i përket trajtimit të akteve të kthyera në rishqyrtim, komunat kanë ndërmarrë veprime në shumicën e rasteve. Nga **94** aktet e kthyera në rishqyrtim, komunat **78** prej tyre i kanë rishqyrtuar, harmonizuar apo janë shfuqizuara, duke dëshmuar një nivel të kënaqshëm të reagimit institucional ndaj rekomandimeve të MAPL-së. Në të njëjtën kohë, **17** akte nuk janë rishqyrtuar, ndërsa **18** akte janë proceduar në Ministrinë e Drejtësisë për inicim të konfliktit administrativ.

## SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË KOMUNAVE NGA MINISTRITË E LINJËS

Ky proces i rishikimit administrativ përbën një mekanizëm kyç për sigurimin e sundimit të ligjit dhe për forcimin e përgjegjshmërisë institucionale në nivel lokal, ku gjatë periudhës raportuese, Ministritë e linjës nga **1,478** akte të miratuara, kanë shqyrtuar **779 akte** apo **52.7%** e totalit.

Nga këto, **779** akte **686** akte janë konfirmuar të ligjshme, që përbën **88.06%** e totalit, duke reflektuar një shkallë relativisht të lartë të përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.

Megjithatë, **93** akte ose **11.93%** janë identifikuar si të kundërligjshme, çka sinjalizon nevojën për përmirësim të mëtejmë të cilësisë normative dhe të proceseve vendimmarrëse në nivel komunal.

Sa i përket trajtimit të akteve të kundërligjshme, evidentohet një reagim kryesisht efektiv institucional. Nga **93** aktet e identifikuara, **92** janë rishqyrtuar, harmonizuar ose shfuqizuar, duke dëshmuar funksionalitet dhe bashkëpunim ndërinstitucional.

Megjithatë, fakti që **një (1)** akt nuk është rishqyrtuar dhe i cili kërkon adresim. Po ashtu, **10** raste janë proceduar në Ministrinë e Drejtësisë për konflikt administrativ, duke reflektuar nevojën për ndërhyrje në nivel më të lartë juridik në raste të caktuara.

*Shtojca nr.7 – Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga ministritë e linjës.*



Në aspektin e mekanizmave të rishqyrtimit, gjatë vitit 2025 janë kthyer për rishqyrtim gjithsej **187** akte, prej të cilave **94** nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe **93** nga ministritë e linjës.

Aktet e kthyera në rishqyrtim kryesisht kanë të bëjnë me:

- Dhënien në shfrytëzim të pronës komunale,
- Këmbimin e pronës komunale,
- Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Shpalljen e interesit publik,
- Miratimin e planeve zhvillimore komunale dhe planeve ndër-komunale për menaxhimin e mbeturinave,
- Caktimin e normave tatimore dhe tarifave komunale,
- Themelimin e komiteteve komunale,
- Hartat zonale dhe planet rregulluese.

Në përfundim, të dhënat tregojnë një trend pozitiv në respektimin e ligjshmërisë nga ana e komunave, por njëkohësisht evidentojnë boshllëqe strukturore në cilësinë e hartimit të akteve dhe në konsistencën e zbatimit të procedurave ligjore.

Njëherësh, procesi i shqyrtimit administrativ ka kontribuar në forcimin e ligjshmërisë, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe parandalimin e zbatimit të akteve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Mirëpo, për të avancuar më tej këtë fushë, rekomandohet forcimi i kapaciteteve profesionale në nivel komunal, standardizimi i proceseve të hartimit të akteve dhe rritja e koordinimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, në mënyrë që të reduktohet incidenca e akteve të kundërligjshme dhe të përmirësohet qeverisja lokale në tërësi.

# AGJENDA EVROPIANE

Zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim është një ndër prioritetet më të rëndësishëm të Republikës së Kosovës e cila është nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian dhe ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016 ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, dokument i cili i obligon institucionet shtetërore t'i kryejnë të gjitha obligimet e kërkuara në këtë proces. Komunat si nivel i veçantë i institucioneve të administratës shtetërore kanë përgjegjësin e tyre në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Në këtë drejtim Ministria e Pushtetit Lokal, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në këtë fushë me nivelin lokal të qeverisjes, gjatë vitit 2025 ka ndërmarrë një sërë veprimesh për adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane, të cilat janë paraqitur në këtë raport. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 kanë raportuar 32 komuna të Republikës së Kosovës ndërsa 6 komuna; Ferizaj, Graçanicë, Kllokot, Mitrovicë Veri, Zubin Potok, Leposaviq, gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar.

- Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kritereve kryesore të integrimit: a) Kriteret Politike, b) Kriteret Ekonomike dhe c) Standardet Evropiane,
- Komunat kanë ofruar informatat në këtë aspekt duke u bazuar në planet e përgjithshme të hartuara nga MAPL, të cilat përfshijnë obligimet më kuadër të: Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, sfidave të qeverisjes lokale të identifikuara nga Raporti i Vendit dhe dokumentet e tjera relevante,
- Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2025 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 64% të aktiviteteve në fushën e kritereve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 71% të kritereve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 65% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2025 është **67%**, si vijon:

*Shtojca nr.1 – Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane.*




## KRITERET POLITIKE

Stabiliteti i institucioneve në qeverisjen demokratike, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve jo shumicë, është një nga kapitujt kryesor të një vendi që duhet përmbushur në raport me agjendën e integrimin evropian. Përmbushja e kritereve politike është obligim i cili duhet përmbushur nga Kosova si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE. Në këtë pjesë të raportit janë përfshirë të dhënat për aktivitetet e komunave në fushën e kritereve politike, me fokus: fuqizimin e administratës publike lokale, bashkëpunimin me shoqërinë civile, luftën kundër terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut dhe komuniteteve jo shumicë, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat pronësore, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe fushat e tjera respektive.

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kritereve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale,

rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, Në 29 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) kanë hartuar programin e trajnimeve për vitin 2025, ndërsa 3 komuna (Pejë, Ranillug, Zveçan) nuk e kanë hartuar këtë program për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejmë të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 32 komuna raportuese janë 16 komuna që kanë hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën raportuese: Deçan, Junik, Gjilan, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malisheve, Obiliq, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë.

Në 16 komuna nuk është hartuar Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën raportuese: Dragash, Fushë Kosovë, Gllogoc, Gjakovë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë.

*Shtojca nr.2 – Programi i trajnimeve dhe strategjia për komunikim me publikun.*




Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani e kanë hartuar 21 komuna për periudhën raportuese: Deçan; Junik; Gjilan; Gllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.

Në 11 komuna nuk e kanë hartuar Planin vjetor të komunikimit për periudhën raportuese: Dragash; Fushë Kosovë; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Zveçan.

Sa i përket zbatimit të Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për standardet minimale të konsultimit publik, janë Në 32 komuna po zbatohet Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për standardet minimale të konsultimit publik: Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc (Drenas); Gjakovë; Hani i  Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë. Mirëpo nëse

shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen në një numër të konsiderueshëm të Komunave. Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani Në 27 komuna është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik: Deçan; Dragash; Junik; Gjilan; Gllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.
Në 5 komuna nuk është caktuar zyrtari përgjegjës për këtë proces: Fushë Kosovë; Pejë; Ranillug; Skenderaj; Zveçan.

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuara një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 30 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) buxheti i ndarë për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve është 11,747,704.06€, ndërsa në 2 Komuna (Mamushë, Zveçan) nuk ka ndarë buxhet. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur 866 OJQ me projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të margjinalizuara, etj. Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 18 Komuna (Dragash; Fushë Kosovë; Gjilan; Gjakovë; Istog; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Pejë; Prishtinë; Prizren; Shtime; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë), janë përkrahur 142 projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 2,000,145.26€, Komuna me numër projektesh por pa shumë të raportuar: Malishevë, Mamushë, Skenderaj.

Në 27 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc, Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet. Në 3 komuna (Gjakovë; Ranillug; Zveçan.) nuk e kanë bërë. Në 2 Komuna (Mamushë; Pejë.) pjesërisht.

Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, andaj më këtë qëllim në 18 komuna (Deçan; Dragash; Junik; Gllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit;

Istog; Kaçanik; Lipjan; Malishevë; Obiliq; Podujevë; Prizren; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë, Mitrovicë e Jugut) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse në 14 komuna (Fushë Kosovë; Gjilan; Klinë; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Prishtinë; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Zveçan.) nuk janë organizuar.

Zbatimi i strategjisë nacionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe strategjisë kundër terrorizmit është zgjeruar edhe në nivelin lokal të administratës. Për mbështetjen dhe parandalimin e terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, 20 komuna kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpijë në ekstremizëm të dhunshëm, si: ligjërata dhe trajnime në shkolla; fushata vetëdijësuese në komunitete; shpërndarje broshurash dhe fletushkash; takime dhe debate me rininë, prindër dhe strukturat arsimore; trajnime për zyrtarë komunalë; bashkëpunim me Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe organizata qytetare/ndërkombëtare; diskutime dhe rekomandime përmes KKSB-së; krijim i hapësirave të sigurta në shkolla për pyetje private rreth çështjeve të ndjeshme; dhe aktivitete në terren për identifikim dhe referim të rasteve të rrezikut. Ndërsa 12 komuna (Fushë Kosovë, Hani i Elezit, Klinë, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtërpcë, Skenderaj) nuk kanë raportuar veprime të tilla për periudhën e raportimit. Në 31 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, ndërsa 1 Komunë (Gjilan) janë paraqitur 5 raste.

Më qëllim të parandalimit dhe menaxhimit të konflikteve të interesit, gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, në 28 komuna nuk është paraqitur asnjë rast i konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Në 4 komuna janë raportuar raste: Gllogoc — 1 rast; Gjakovë — 1 rast; Klinë — 3 raste; Kamenicë — 5 raste, pra gjithsej 10 raste të paraqitura të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal.
Sa i përket anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës, në 4 komuna (Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Shtime) janë paraqitur 30 raste; në 28 komuna nuk është raportuar asnjë rast i tillë.

Nga të dhënat e pranuara, 28 komuna kanë përgjigjur Po — pra kanë hartuar Planin Lokal për Integritet sipas Ligjit Nr. 03/L-159: Deçan, Dragash, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri dhe Kamenicë. 4 komuna kanë përgjigjur Jo — nuk e kanë hartuar planin: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë dhe Zveçan.
Pjesa më e madhe e komunave sipas raportimeve e kanë të caktuar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 32 komuna raportuese 27 komuna kanë koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me Planin Lokal për Integritet. 5 komuna nuk kanë koordinator të tillë: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë, Ranillug, Zveçan.

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë **25** komuna të cilat kanë ndërmarrë veprimet si; organizim i trajnimeve, kurse për gjuhen serbe dhe shqipe, janë punësuar zyrtarë për përkthim, ofrohen shërbime simulante nëpër të gjitha takimet zyrtare, materialet e organeve komunale përkthehen të gjitha në gjuhë zyrtare, shpërndahen broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitete etj. ndërsa 7 komuna nuk kanë raportuar masa të tilla (Hani i Elezit, Kaçanik, Malishevë, Pejë, Prishtinë, Skenderaj, Zveçan).

Implementimi efektiv i legjislacionit për trashëgiminë kulturore ka qenë pjesë e angazhimeve të vazhdueshme të organeve komunale. Sipas të dhënave, Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e kanë hartuar vetëm **7** komuna (Deçan; Dragash; Junik, Istog; Kaçanik; Prizren; Rahovec), të cilat kanë hartuar këtë plan.

Sfidat që 25 komuna (Fushë Kosovë; Gjilan; Gllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë.) nuk e kanë miratuar këtë Plan janë: Mungesa e stafit profesional, mungesa e ekspertëve, mungesa e mjeteve buxhetore, sfidat lidhur me regjistrimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore ekzistuese etj.

Numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale 12 Komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Malishevë, Podujevë, Prizren, Shtërpcë, Viti, Kamenicë) janë evidentuar 12 shkelje në zonat e mbrojtura, ndërsa në 20 Komuna (Dragash, Gjilan, Gllogoc/Drenas, Hani i Elezit, Lipjan, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Zveçan, Junik) nuk është raportuar asnjë rast.

Gjithashtu me qëllim për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë këto aktivitete; Promovimi i aseteve të trashëgimisë në media televizive, postimit e fotografive nga asetet e trashëgimisë kulturore, është bërë projekti për restaurimin e disa objekteve të trashëgimisë kulturore, pastrimi i qytetit, shpërndarja e broshurave, vetëdijesimi i qytetarëve, restaurimeve, aktiviteteve edukative, ekspozitave dhe projekteve kulturore, hartimi i hartave zonale dhe broshurave për promovim të turizmit, vizita të ndryshme në objektet që janë nën mbrojtje etj.

Në 9 Komuna (Gllogoc, Hani i Elezit; Kaçanik; Klinë; Partesh; Rahovec; Ranillug; Suharekë; Zveçan) nuk janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive te objekteve të trashëgimisë kulturore objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj, në 12 Komuna (Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gjakovë; Istog; Lipjan; Mamushë; Obiliq; Pejë; Podujevë; Prizren; Shtime.) janë siguruar këto pajisje, dhe në 11 Komuna (Deçan; Dragash; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Prishtinë; Shtërpcë; Skenderaj; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) janë siguruar pjesërisht.

Sa i përket nënshkrimit të Memorandumeve të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse (vetëm komunat që kanë objekte kishtare), në 24 komuna ka objekte kishtare; nga këto, 7 komuna (Istog, Klinë, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prizren, Kamenicë) kanë nënshkruar Memorandume; 17 komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zveçan) nuk kanë nënshkruar Memorandume; 8 komuna nuk kanë objekte kishtare ortodokse (Dragash, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Malishevë, Mamushë, Junik).

Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoqën e Madhe, Kuvendi I komunës se Rahovecit me datën 28.02.2022 ka marre vendim për inicimin e themelimit te këtij këshilli.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar - Dhjetor 2025 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet. Nuk ka pasur ndërtime ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Kuvendi i komunës se Rahovecit me datën 28.02.2022, ka marr vendim për inicimin e themelimit te këtij këshilli për të cilin ka ndarë buxhet në vlerë prej 30.670 për vitin 2025, për të mundësuar funksionimin e tij.
Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoqën e Madhe, Kuvendi I komunës se Rahovecit me datën 28.02.2022 ka marre vendim për inicimin e themelimit te këtij këshilli.

## KRITERET EKONOMIKE

Zhvillimi ekonomik mbetet një nga prioritetet kryesore në nivel vendi. Politikat ekonomike përbëjnë substancën programore pothuajse të të gjithë mekanizmave të administratës shtetërore, përfshirë këtu komunat të cilat kanë një rol të padiskutueshëm në këtë drejtim.

Sa i përket aktiviteteve konkrete të parapara në planet e komunave të kësaj fushë, gjatë vitit 2025 në **29** komuna janë krijuar kushte të nevojshme për funksionimin e qendrave one-stop-shop, të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese, përfshirë regjistrimin e tyre. Megjithëse, janë edhe **3** komuna (Prishtinë, Ranillug, Partesh) të cilat ende nuk i kanë funksionalizuar qendrat për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et). Numri i inspektorëve të tregut në 27 komuna është 70, ndërsa janë 4 Komuna (Novobërdë; Pejë; Shtërpcë; Zveçan.) nuk kanë inspektor dhe Komuna e Prishtinës ka theksuar se që nuk është kompetencë e Komunës. Gjithashtu numri i inspektimeve në 25 komuna është 4,405 inspektime, ndërsa 7 Komuna (Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Prishtinë; Shtërpcë; Zveçan.) nuk ka pasur inspektime.
Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 26 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 6 komuna (Mamushë; Novobërdë; Ranillug; Viti; Zveçan, Pejë) nuk është publikuar.
Në 19 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, në 13 Komuna (Gjilan; Gjakovë; Hani i Elezit; Klinë; Mamushë; Novobërdë; Obiliq; Prishtinë; Prizren; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë; Pejë) nuk është bërë ende funksionalizimi i zonave ekonomike.

Komunat po ashtu, janë koncentruar edhe në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, ngase sfidë mbetet sidomos shpenzimi i mjeteve buxhetore në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Zbatimi i rekomandimeve të auditorit ndikon në përmirësimin e menaxhimit të financave publike për një performancë sa më të mirë dhe shërbime më të mira ndaj qytetarëve.

Gjatë periudhës vitit 2025, nga 32 komuna raportuese 26 prej tyre kanë pranuar 305 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm, Komunat të cilat kanë rekomandime janë (Deçan 7; Dragash 6; Fushë Kosovë 15; Junik 3; Gjilan 14; Gllogoc 11; Gjakovë 10; Kaçanik 14; Klinë 8; Lipjan 15; Malishevë 24; Mamushë 3; Mitrovicë e Jugut 13; Novobërdë 15; Obiliq 9; Partesh 5; Podujevë 13; Prishtinë 27; Prizren 12; Rahovec 6; Shtime 8; Shtërpcë 11; Skenderaj 11; Viti 13; Vushtrri 27; Kamenicë 5) ndërsa Komuna pa rekomandime janë 2 (Istog, Suharekë) dhe 4 Komuna nuk kane siguruar te dhëna (Hani i Elezit, Pejë, Ranillug, Zveçan). Prej tyre të adresuar janë 174 rekomandime, të pa adresuara mbesin 88 rekomandime dhe 146 rekomandime gjenden në proces.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 27 komuna dhe ka 48 zyrtarë, ndërsa 4 komuna (Hani i Elezit; Mamushë; Partesh; Zveçan.) nuk funksionon, Komunat pa përgjigje (Pejë).

Në 25 Komuna (Përmbledhje: Themelimi i komitetit për auditim të brendshëm është bërë në 25 komuna Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc/Drenas, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) është themeluar komiteti për auditim të brendshëm, ndërsa në 6 Komuna (Hani i Elezit, Istog, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Zveçan) nuk është themeluar. Komuna Pejë nuk ka dhënë përgjigje.
Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 27 komuna janë mbajtur 274 dëgjime publike, kurse në 5 komuna (Deçan; Mamushë; Pejë; Ranillug; Shtime.) nuk janë mbajtur.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 në 29 Komuna numri i bizneseve të regjistruara është 7,124 biznese. Ndërsa numri i bizneseve të mbyllura në 27 Komuna është 839 biznese, në 3 Komuna (Partesh, Ranillug, Zveçan) nuk ka pasur të dhëna. Një ndër aktivitetet që kanë rëndësi në agjendën Evropiane është edhe mbështetja e grave në udhëheqjen e bizneseve, e që gjatë vitit 2025 numri i bizneseve të udhëhequra nga gratë në 28 Komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është 2,402 biznese, ndërsa në 3 Komuna (Mamushë, Ranillug, Zveçan) nuk ka biznese të udhëhequra nga gratë; për Prishtinë nuk ka informatë të siguruar.

Buxheti i ndarë në 19 Komuna (Dragash; Fushë Kosovë; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Kaçanik; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Pejë; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Skenderaj; Viti; Kamenicë.) për subvencionimin e bizneseve është 2,512,422.60 €, ndërsa

në 13 Komuna (Deçan; Junik; Istog; Klinë; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Suharekë; Vushtrri; Zveçan.) nuk kanë ndarë buxhet për subvencionimin e bizneseve gjatë periudhës raportuese.

## STANDARDET EVROPIANE

Komponentë kryesore e zhvillimit ekonomik lokal mbetet sektori i bujqësisë, përkatësisht zbatimi i duhur dhe efektiv i politikave të cilat janë thelbësore për funksionimin e politikave të përbashkëta bujqësore evropiane. Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që nga 32 Komuna raportuese vetëm në 12 komuna (Dragash; Junik; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Malishevë; Partesh; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime) është hartuar Plan Programi  për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa ne 20 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Gjilan; Kaçanik, Klinë; Lipjan; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Pejë; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë) ende nuk është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural, në 27 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) janë funksionalizuar këto qendra. Në 5 komuna (Hani i Elezit, Partesh, Podujevë, Skenderaj, Zveçan) nuk janë funksionalizuar. Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së bujqësisë, në 27 komuna (Deçan, Dragash, Fushe Kosove, Gjilan, Gllogoc, Gjakove, Hani I Elezit, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malisheve, Mamushë, Mitrovice Juge, Obiliq, Partesh, Peje, Podujeve, Prishtine, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suhareke, Viti, Kamenice) është ofruar mbështetje për 9,454 fermerë në sektorët e bletarisë, blegtorisë, perimtarisë, pemëtarisë, bimëve foragjere dhe hortikulturës; për komunën e Kamenicës është raportuar se ka mbështetje, por numri i fermerëve nuk është dhënë në të dhënat e pranuara. Ndërkaq, 5 komuna (Junik, Istog, Novobërdë, Vushtrri, Zveçan) nuk kanë raportuar mbështetje për fermerët gjatë periudhës raportuese.

Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 10 komuna (Dragash, Hani i Elezit, Istog, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Shtime, Viti). Në 22 komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Prizren, Rahovec, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë.) nuk është hartuar.

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA, komunat kanë avancuar politikat e efiçiencës së energjisë. Planin për Efiçiencë të Energjisë e kanë miratuar 18 komuna: Deçan, Dragash, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Malishevë, Mamushë, Obiliq, Partesh, Prizren,

Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Viti; ndërsa në 14 komuna (Fushë Kosovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë) ky plan ende nuk është hartuar.

Me qëllim të zbatimit të Planit për Efiçiencë të Energjisë, komunat kanë nisur një sërë projektesh konkrete për përmirësimin e performancës energjetike të objekteve publike dhe infrastrukturës. Nga të dhënat e dhëna, 22 komunat Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë, Viti dhe Kamenicë kanë raportuar aktivitete konkrete (renovime, vendosje panele diellore, ndriçim LED, izolime, etj.).
Ndërkaq, 10 Komunat Klinë, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Ranillug, Skenderaj, Shtërpcë, Vushtrri dhe Zveçan nuk kanë pasur aktivitete të përmendura në të dhëna.

Me qëllim të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel komunal, zyrtari përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është emëruar në 28 komuna: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë. Në 4 komuna nuk është emëruar zyrtari përkatës: Novobërdë, Pejë, Prishtinë, Zveçan.
Sa i përket zyrtarit për barazi gjinore është caktuar në 30 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.), ndërsa në 2 komuna (Ranillug; Zveçan.) nuk është emëruar zyrtari përkatës.

*Shtojca nr.3 – Mekanizmat lokal për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit.*



Një ndër sfidat e evidentuara nga raporti i KE-së për Kosovën për nivelin lokal është kujdesi për të moshuarit mbetet një çështje serioze. Nga të dhënat e ofruara rezulton se në **20** komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Junik, Gllogoc (rajonale), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Klinë, Lipjan, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti (shërbim i lidhur me Prishtinën), Vushtrri, Kamenicë (shërbim i lidhur me Prishtinën), Mitrovicë e Jugut (Qendra rajonale Skenderaj), ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit në komunat e tyre apo regjionale, ndërsa **12** komuna (Dragash, Gjilan, Kaçanik, Malishevë, Mamushë, Obiliq, Partesh, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtërpcë, Zveçan), nuk ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit.

Një ndër sfidat e evidentuara nga raporti i KE-së për Kosovën për nivelin lokal është kujdesi për të moshuarit mbetet një çështje serioze. Nga të dhënat e ofruara rezulton se në 20 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Junik; Gllogoc (rajonale); Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Klinë; Lipjan; Novobërdë; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Shtime; Skenderaj; Suharekë; Viti (shërbim i lidhur me Prishtinën); Vushtrri; Kamenicë (shërbim i lidhur me Prishtinën), Mitrovicë e Jugut ( Qendra rajonale Skenderaj) ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit në komunat e tyre apo regjionale, ndërsa 12 komuna (Dragash; Gjilan; Kaçanik; Malishevë; Mamushë; Obiliq; Partesh; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtërpcë; Zveçan) nuk ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit.

Një tjetër e gjetur nga raporti i KE-së për Kosovën ka qenë edhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje. Planin e Veprimit kundër dhunës në familje në 24 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Kamenicë) është hartuar, ndërsa në 8 komuna (Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë, Vushtrri, Zveçan) nuk është hartuar ende.
Shqetësuese mbeten rastet e dhunës në familje ku sipas raporteve në 24 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) janë trajtuar 1,387 raste. Në 4 komuna (Mamushë, Partesh, Rahovec, Ranillug) nuk është trajtuar asnjë rast i dhunës në familje.
Komunat pa të dhëna të plota për këtë pyetje janë 4: Klinë (mungojnë të dhënat për raste dhe trajtim), Pejë (mungojnë të dhënat), Zveçan (mungojnë të dhënat) dhe Gjilan (raporton 201 raste por nuk ka dhënë informacion nëse janë trajtuar).
Një ndër sfidat e evidentuara nga raporti i KE-së për Kosovën për nivelin lokal është kujdesi për të moshuarit mbetet një çështje serioze. Nga të dhënat e ofruara rezulton se në 20 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Junik; Gllogoc (rajonale); Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Klinë; Lipjan; Novobërdë; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Shtime; Skenderaj; Suharekë; Viti (shërbim i lidhur me Prishtinën); Vushtrri; Kamenicë (shërbim i lidhur me Prishtinën), Mitrovicë e Jugut ( Qendra rajonale Skenderaj) ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit në komunat e tyre apo regjionale, ndërsa 12 komuna (Dragash; Gjilan; Kaçanik; Malishevë; Mamushë; Obiliq; Partesh; Prizren;

Rahovec; Ranillug; Shtërpcë; Zveçan) nuk ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit.

Një tjetër e gjetur nga raporti i KE-së për Kosovën ka qenë edhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje. Planin e Veprimit kundër dhunës në familje në 24 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Kamenicë) është hartuar, ndërsa në 8 komuna (Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë, Vushtrri, Zveçan) nuk është hartuar ende.
Shqetësuese mbeten rastet e dhunës në familje ku sipas raporteve në 24 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) janë trajtuar 1,387 raste. Në 4 komuna (Mamushë, Partesh, Rahovec, Ranillug) nuk është trajtuar asnjë rast i dhunës në familje.
Komunat pa të dhëna të plota për këtë pyetje janë 4: Klinë (mungojnë të dhënat për raste dhe trajtim), Pejë (mungojnë të dhënat), Zveçan (mungojnë të dhënat) dhe Gjilan (raporton 201 raste por nuk ka dhënë informacion nëse janë trajtuar).

Sa i përket themelimit të këshillit komunal apo mekanizmit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore, Nga të dhënat e dhëna, 28 komuna kanë përgjigjur Po (kanë mekanizëm për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje): Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti dhe Vushtrri. Ndërsa 4 komuna kanë përgjigjur Jo: Mitrovicë e Jugut, Partesh, Zveçan dhe Kamenicë

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku në 30 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) numri i grave në pozita menaxheriale është **755**. Ne 2 komuna (Zveçan, Mamushë) nuk është raportuar qe ka gra ne pozita menxhaeriale. Krahas tyre, në administratën publike lokale, duke përfshirë edhe Kuvendin e Komunës, në 30 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) numri total i përfaqësimit të grave është **7,937**. Ndërkaq, dy komuna (Ranillug dhe Zveçan) nuk kane gra të përfaqësuar në administratë/kuvend. Sa i përket raportit statistikor (gjinor) të drejtorëve të drejtorive komunale, në 27 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Viti, Vushtrri,

Zveçan, Kamenicë) janë 85 drejtoresha. Ndërsa në 5 komuna (Klinë, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Skenderaj) nuk ka asnjë drejtore.

Në emër të dy bashkëshortëve gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, sipas raportimeve të komunave, në 29 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) janë regjistruar 6,476 prona në emër të dy bashkëshortëve. Ndërsa në 3 komuna (Hani i Elezit, Klinë, Zveçan) nuk ka pasur prona te regjistruara në emër të dy bashkëshortëve gjatë periudhës raportuese.

Sfidë tjetër e identifikuar nga raporti i Komisionit Evropian për nivelin lokal të qeverisjes është edhe zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, gjë për të cilën një numër i konsiderueshëm i komunave kanë shfaqur vështirësi në zbatimin e tij: mungesë e kuadrit adekuat dhe e zyrtarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; mungesë mjetesh financiare dhe buxheti i pamjaftueshëm; mungesë e shërbimeve të specializuara (strehimore, psikologë, linja ndihme); mungesë trajnimesh të rregullta dhe kapaciteteve profesionale; bashkëpunim ndërinstitucional jo i mjaftueshëm; vonesa në identifikimin dhe raportimin e rasteve; mungesë e mekanizmave efikase për dëgjime publike; nevoja për fushata informuese dhe rritje të vetëdijesimit të prindërve dhe komuniteteve; mungesë e familjeve strehuese dhe qendrave për mbrojtje; dhe nevoja për materiale promovuese, ekspertizë dhe zbatimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve.

Në 28 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) janë themeluar mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si: ekipet komunale për të drejtat e fëmijëve, emërimi i zyrtarëve për të drejtat e fëmijëve, formimi i grupeve punuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe themelimi i asambleve komunale të fëmijëve.
Ndërsa në 4 komuna (Prishtinë, Ranillug, Skenderaj, Zveçan) nuk janë themeluar ekipe/ mekanizma të tilla sipas të dhënave të raportuara.

Në 23 komuna është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës: Kamenicë, Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Partesh, Pejë, Podujevë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri.
Në 9 komuna nuk është caktuar ende zyrtari për mbrojtjen e fëmijës: Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Shtërpcë, Viti, Zveçan.

Në 26 komuna hapësirat e punës në institucionet lokale janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti dhe Kamenicë. Në 6 komuna nuk janë të

qasshme hapësirat e punës: Gjakovë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Vushtrri dhe Zveçan.
Në bazë të të dhënave të raportuara, 27 komuna kanë deklaruar se objektet arsimore janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa 5 komuna raportuan se objektet nuk janë të qasshme.
Komunat që raportuan qasje (27): Deçan; Dragash; Junik; Gjilan; Gllogoc Drenas; Gjakovë; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Kamenicë.
Komunat që raportuan mungesë qasjeje (5): Hani i Elezit; Novobërdë; Viti; Vushtrri; Zveçan.

Sipas të dhënave të raportuara, në 29 komuna është deklaruar se personat me aftësi të kufizuara kanë asistencën e duhur në procesin mësimor sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë. Në 3 komuna raportuan se nuk ofrojnë asistencën e duhur: Gjakovë, Hani i Elezit, Zveçan.

Sipas të dhënave të raportuara, në 25 komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Kamenicë) ofrohet kujdestari për fëmijët pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi ndërsa në 7 komuna (Dragash, Mamushë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Zveçan) nuk ofrojnë kujdestari të tilla sipas raportimeve.

Në 17 komuna është miratuar Plani tre vjeçar për strehim social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit: Deçan, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë.
Në 15 komuna Plani tre vjeçar nuk është miratuar: Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Hani i Elezit, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë.

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar është funksionalizuar në 15 komuna (Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Istog, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Rahovec, Shtime dhe Suharekë), ndërsa në 17 komuna (Deçan, Hani i Elezit, Kaçanik, Klinë, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Ranillug,Shtërrpcë, Skenderaj, Viti, Vushtrri, Zveçan dhe Kamenicë) nuk është themeluar. Sa i përket ndihmës juridike falas për qytetarët e Republikës së Kosovës nga 6 Komuna vetëm në 4 Komuna (Prizren, Prishtine, Gjilan, Gjakovë) është funksionalizuar zyra rajonale për ndihmi juridike falas, dhe 1 Komuna (Pejë ) nuk e kanë funksionalizuar. Janë themeluar në 24 komuna:

Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc (Drenas); Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë. Nuk janë themeluar në 7 komuna: Deçan; Mamushë; Pejë; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Zveçan. Ndërsa Mitrovicë e Jugut është shënuar si "Nuk është në kuadër të komunës" dhe është përjashtuar nga numërimi.
Numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në 21 komuna (Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc (Drenas), Gjakovë, Istog, Klinë, Lipjan, Malishevë, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri dhe Kamenicë.) është 2,009 kërkesa; në 11 komuna (Deçan, Hani i Elezit, Kaçanik, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Ranillug, Shtërpcë dhe Zveçan.) nuk është paraqitur asnjë kërkesë gjatë periudhës raportuese.

Nga të dhënat e përmbledhura, 18 komuna që kanë komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian, ku është themeluar komiteti lokal janë: Fushë Kosovë, Gjilan, Gjakovë, Istog, Klinë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë, Viti, Vushtrri dhe Kamenicë. 7 komuna që kanë komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian por komiteti nuk është themeluar janë: Deçan, Kaçanik, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Skenderaj dhe Zveçan. Për 7 komuna të tjera është raportuar se nuk kanë komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian: Dragash, Junik, Gllogoc (Drenas), Hani i Elezit, Partesh, Ranillug dhe Shtërpcë.

Një ndër sfidat e raportit të KE-së për Kosovën është edhe hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Ri integrim për të cilin plan në 30 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është hartuar Planit Lokal të Veprimit për Ri integrim, ndërsa ne 2 komuna (Prizren; Zveçan.) ende nuk është miratuar ky plan.

Në 27 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc (Drenas); Gjakovë; Hani i Elezit; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është themeluar Komisionin Komunal për Ri integrim (KKR), ndërsa në 5 Komuna (Istog; Novobërdë; Partesh; Shtërpcë; Zveçan.) nuk është themeluar.

Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur, dhe përkrahja nga niveli lokal ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Në 17 komuna (Dragash; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Mamushë; Obiliq; Pejë; Rahovec; Ranillug; Shtime; Skenderaj; Viti; Kamenicë.) numri i personave të zhvendosur është 388 persona, ndërsa në 15 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Junik; Hani i Elezit; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Shtërpcë; Suharekë; Vushtrri; Zveçan.) nuk raportohet asnjë rast.
Sa i përket aplikimit për asistencë nga fondi për ri-integrim në 20 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Pejë;

Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtërpcë; Vushtrri; Kamenicë.) numri i aplikimeve është 236, ndërsa 12 komuna (Junik; Hani i Elezit; Malishevë; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Ranillug; Shtime; Skenderaj; Suharekë; Viti; Zveçan.) nuk ka pasur aplikime.

Zhvillimi i sistemit të arsimit dhe ngritja e kapaciteteve në arsimin gjithëpërfshirës kanë vazhduar në komuna, për të cilën fushë në 25 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë ; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Skenderaj; Suharekë; Zveçan; Kamenicë) janë organizuar 222 trajnime për mësimdhënës. Në 7 komuna të tjera (Mamushë; Ranillug; Shtërpcë; Viti; Vushtrri, Klinë, Pejë) nuk ka pasur trajnime.

Në 28 Komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë) numri i çerdheve është 169. Ndërsa në 3 Komuna (Mamushë, Novobërdë, Zveçan) nuk kanë çerdhe, dhe Komuna e Pejës nuk ka ofruar të dhëna.

Sa i përket rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor, në 28 komuna numri i fëmijëve të moshës 0-5 vjeç që ndjekin arsimimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme është 9,821 fëmijë, 4 komuna ( Mamushë, Novobërdë, Pejë, Zveçan) nuk kanë ofruar të dhëna.
Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe në 22 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë) është 165 fëmijë. Numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian në 9 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Gjakovë; Istog; Klinë; Obiliq; Podujevë; Prishtinë; Shtime.) është 66 raste.

Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit të shkollimit për komunitet jo shumicë (Rome dhe Ashkali) është i hartuar vetëm në 11 Komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Gjakovë; Istog; Lipjan; Malishevë; Obiliq; Prishtinë; Shtime; Shtërpcë; Suharekë.).
Në 24 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Kamenicë) janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla.

Komunat mbeten të përkushtuara në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, 28 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Gllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë;

Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është hartuar Plani për menaxhimin e mbeturinave, në 4 komuna (Novobërdë; Pejë; Ranillug; Zveçan.) nuk është hartuar.
Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, në 21 komuna janë zhvilluar 152 fushata ndërsa në 11 komuna (Klinë; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Podujevë; Rahovec; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Zveçan.) nuk ka pasur fushata.

Në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, janë 25 komuna që kanë organizuar fushata vetëdijësuese, ndërsa në 7 komuna (Hani i Elezit; Istog; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Shtërpcë; Skenderaj.) nuk ka pasur asnjë fushatë.
Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, në 24 komuna janë mbajtur 284 trajnime kurse në 8 komuna (Hani i Elezit, Istog, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Shtërpcë, Skenderaj, Zveçan) nuk është mbajtur asnjë trajnim.

# FINANCAT LOKALE

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në mandatin e saj ligjor dhe planit të punës për vitin 2026, përgatitë raportin e funksionimit të komunave ku raporti i të hyrave vetanake të komunave është pjesë integrale e këtij raporti. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal përcakton se burimet e të hyrave komunale, përveç grantit qeveritar përbëhen edhe nga të hyrat vetanake, të cilat mblidhen nga komunat në emër të shërbimeve të ofruara për qytetarët edhe pse në përgjithësi kanë një pjesëmarrje të ulët në buxhetin total të komunave. Të hyrat vetanake të komunave nga tatimet dhe taksat përbëjnë shtyllën kryesore prej së cilës varet qëndrueshmëria financiare e një komune, ato kontribuojnë në mbushjen e buxhetit të një komune dhe si të tilla përbëjnë burim të rëndësishëm të të ardhurave komunale. Të hyrat komunale ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Komunave të Republikës së Kosovës.

## PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE

Për vitin 2025, planifikimi i të hyrave vetanake është në vlerë prej **114,283,838.00€,** ku krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2024, në vlerë prej **105,523,577.00€,** del që planifikimi për vitin 2025 ka qenë më i lartë për **8,760,261.00€,** ose shprehur në përqindje 8.30%.

Gjithashtu realizimi i të hyrave për vitin 2025, prej **121,572,826.59€,** krahasuar me planifikimin prej **114,283,838.00€**, ka një tejkalim të planit prej 6.38 %, krahasuar me vitin 2024 që realizimi nuk kishte arritur planin vjetor për (- 5.63%).

## REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE

Realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte për vitin 2025 ka arritur vlerën prej 147,717,346.46€, prej të cilave 121,572,826.59€ kanë qenë të hyra direkte dhe 26,144,519.87€ kanë qenë të hyra indirekte. Nëse kjo vlerë krahasohet me vlerën totale të planifikuar, në shumën prej

114,283,838.00€, atëherë shohim që realizimi ka arritur nivelin prej 129.25%.
Inkasimi i të hyrave vetanake direkte për vitin 2025 në vlerë prej 121,572,826.59€ krahasuar me inkasimin e të hyrave të llojit të njëjtë për vitin 2024 në vlerë prej 99,583,077.74€, është më i lartë prej 21,989,748.85€, apo 22.08%.

Në bazë të përqindjes së inkasimit të të hyrave vetanake, komunat që kanë nivel më të lartë të realizimit janë si vijon: Fushë Kosova 139.25%, Lipjani 106.67%, Obiliqi 114.92%, Podujeva 108.41%, Prishtina 111.87%, Graçanica 96.26%, Rahoveci 110.43%, Suhareka 94.68%, Malisheva 132.29%, Deçani 100.66%, Gjakova 91.91%, Istogu 149.99%, Klina 94.40%, Peja 117.43%, Mitrovica 95.31%, Vushtrria 109.56%, Mitrovica Veriore 190.33%, Gjilani 98.54%, Novobërda 120.39%, Ferizaj 108.51%, Vitia 100.69%, Parteshi 94.29%, Hani I Elezit 388.21%, Ranillugu 128.24%.

Komunat të cilat kanë treguar realizim mesatar të inkasimit janë: Gllogovci 86.68%, Shtime 87.97%, Dragashi 85.76%, Prizreni 88.81%, Mamusha 84.46%, Juniku 73.75%, Skenderaji 84.71%, Kaçaniku 84.39%, Kamenica 82.31%, Shtërpca 75.06%, Kllokoti 61.71%.
Ndërsa % me të uletë të realizimit të të hyrave kanë komunat si: Leposaviqi 28.04%, Zubin Potoku 23.04%, Zveçani 13.22%.

Të hyrat që kanë një ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë tatimi në pronë i cili gjatë vitit 2025 është inkasuar në shumën prej 39,177,938.91€, një lloj tjetër i të hyrave që ka ndikim në rritjen e të hyrave vetanake janë edhe të hyrat komunale për leje ndërtimi për ku për periudhën raportuese janë inkasuar shuma prej 44,526,469.09€.

*Shtojca nr.1 – Krahasimi i planifikimit dhe realizmit të hyrave vatanake 2024 dhe 2025.*

| Realizimi I Të hyrat vetanake 2025 dhe krahasimi me vitin 2024 | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2024 | | | Viti 2025 | | | Krahasimi 2025/2024 | | | | Indexi krahasues I tejkalimit planit mes te viteve 2024/2025 I shprehur ne % |
| Planifikimi I te hyrave vetanake | Realizimi I te hyrave vetanake | % e realizimit | Planifikimi I te hyrave vetanake | Realizimi I te hyrave vetanake | % e realizimit | Krahasimi I planifikimit 2025/2024 | Krahasimi I planifikimit 2025/2024 I shprehur ne % | Krahasimi I realizimit 2025/2024 | Krahasimi I realizimit 2025/2024 I shprehur ne % | |
| 105,523,577.00 | 99,583,077.74 | 94.37 | 114,283,838.00 | 121,572,826.59 | 106.38 | 8,760,261.00 | 8.30 | 21,989,748.85 | 22.08 | 12.01 |

Në tabelë vërehet planifikimi dhe realizimi i të hyrave për vitin 2024 dhe 2025. Nëse bëjmë krahasim vërejmë se planifikimi në krahasim me këto dy vite është 8.30% me i lartë në vitin 2025 se në vitin 2024. Kurse realizmi i të hyrave vetanake në krahasim me vitin 2024, në vitin 2025 realizmi është 22.08 % me i lartë.

*Shtojca nr.2  – Indeksi i tejkalimeve në mes viteve.*

| Komunat | Realizimi I Të hyrat vetanake 2025 dhe krahasimi me vitin 2024 | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Viti 2024 | | | **Viti 2025** | | | **Krahasimi 2025/2024** | | | | Indexi krahasues I tejkalimit planit mes te viteve 2024/2025 I shprehur ne % |
| | Planifikimi I te hyrave vetanake | Realizimi I te hyrave vetanake | % e realizimit | Planifikimi I te hyrave vetanake | Realizimi I te hyrave vetanake | % e realizimit | Krahasimi I planifikimit 2025/2024 | Krahasimi I planifikimit 2025/2024 I shprehur ne % | Krahasimi I realizimit 2025/2024 | Krahasimi I realizimit 2025/2024 I shprehur ne % | |
| Gllogovc | 1,560,705.00 | 1,718,887.01 | 110.14 | 1,936,467.00 | 1,678,619.23 | 86.68 | 375,762.00 | 24.08 | (40,267.78) | (2.34) | (23.45) |
| Fushë Kosovë | 3,714,607.00 | 4,039,204.96 | 108.74 | 3,459,675.00 | 4,817,444.94 | 139.25 | (254,932.00) | (6.86) | 778,239.98 | 19.27 | 30.51 |
| Lipjan | 2,532,006.00 | 3,135,804.28 | 123.85 | 3,174,047.00 | 3,385,650.87 | 106.67 | 642,041.00 | 25.36 | 249,846.59 | 7.97 | (17.18) |
| Obiliq | 1,255,245.00 | 917,530.99 | 73.10 | 1,291,588.00 | 1,484,324.34 | 114.92 | 36,343.00 | 2.90 | 566,793.35 | 61.77 | 41.83 |
| Podujevë | 1,859,659.00 | 1,711,013.95 | 92.01 | 1,986,336.00 | 2,153,415.88 | 108.41 | 126,677.00 | 6.81 | 442,401.93 | 25.86 | 16.40 |
| Prishtinë | 38,778,968.00 | 32,395,922.64 | 83.54 | 38,778,968.00 | 43,382,111.80 | 111.87 | - | - | 10,986,189.16 | 33.91 | 28.33 |
| Shtime | 569,700.00 | 558,061.57 | 97.96 | 858,258.00 | 755,044.90 | 87.97 | 288,558.00 | 50.65 | 196,983.33 | 35.30 | (9.98) |
| Graçanicë | 2,290,078.00 | 2,517,245.20 | 109.92 | 2,729,206.00 | 2,627,083.67 | 96.26 | 439,128.00 | 19.18 | 109,838.47 | 4.36 | (13.66) |
| Dragash | 464,450.00 | 442,296.20 | 95.23 | 551,054.00 | 472,560.81 | 85.76 | 86,604.00 | 18.65 | 30,264.61 | 6.84 | (9.47) |
| Prizren | 10,193,294.00 | 8,411,212.36 | 82.52 | 10,600,777.00 | 9,414,946.50 | 88.81 | 407,483.00 | 4.00 | 1,003,734.14 | 11.93 | 6.30 |
| Rahovec | 1,614,904.00 | 1,863,076.94 | 115.37 | 2,001,711.00 | 2,210,469.48 | 110.43 | 386,807.00 | 23.95 | 347,392.54 | 18.65 | (4.94) |
| Suharekë | 2,252,469.00 | 2,457,095.64 | 109.08 | 2,401,424.00 | 2,273,685.48 | 94.68 | 148,955.00 | 6.61 | (183,410.16) | (7.46) | (14.40) |
| Malishevë | 916,849.00 | 1,907,693.69 | 208.07 | 1,505,526.00 | 1,991,682.03 | 132.29 | 588,677.00 | 64.21 | 83,988.34 | 4.40 | (75.78) |
| Mamushë | 71,552.00 | 83,328.49 | 116.46 | 98,782.00 | 83,432.56 | 84.46 | 27,230.00 | 38.06 | 104.07 | 0.12 | (32.00) |
| Deçan | 847,565.00 | 871,200.24 | 102.79 | 900,571.00 | 906,488.03 | 100.66 | 53,006.00 | 6.25 | 35,287.79 | 4.05 | (2.13) |
| Gjakovë | 5,091,658.00 | 5,869,692.01 | 115.28 | 5,934,237.00 | 5,454,005.97 | 91.91 | 842,579.00 | 16.55 | (415,686.04) | (7.08) | (23.37) |
| Istog | 1,306,223.00 | 1,927,456.89 | 147.56 | 1,496,509.00 | 2,244,606.68 | 149.99 | 190,286.00 | 14.57 | 317,149.79 | 16.45 | 2.43 |
| Klinë | 1,436,260.00 | 1,289,763.07 | 89.80 | 1,495,504.00 | 1,411,753.82 | 94.40 | 59,244.00 | 4.12 | 121,990.75 | 9.46 | 4.60 |
| Pejë | 5,365,017.00 | 5,339,289.22 | 99.52 | 5,593,510.00 | 6,568,283.43 | 117.43 | 228,493.00 | 4.26 | 1,228,994.21 | 23.02 | 17.91 |
| Junik | 208,056.00 | 156,804.13 | 75.37 | 204,942.00 | 151,144.37 | 73.75 | (3,114.00) | (1.50) | (5,659.76) | (3.61) | (1.62) |
| Leposaviq | 96,985.00 | 10,465.00 | 10.79 | 100,720.00 | 28,238.61 | 28.04 | 3,735.00 | 3.85 | 17,773.61 | 169.84 | 17.25 |
| Mitrovicë | 3,288,174.00 | 2,710,413.69 | 82.43 | 3,615,495.00 | 3,446,038.53 | 95.31 | 327,321.00 | 9.95 | 735,624.84 | 27.14 | 12.88 |
| Skenderaj | 1,299,271.00 | 1,578,300.97 | 121.48 | 1,709,466.00 | 1,448,163.53 | 84.71 | 410,195.00 | 31.57 | (130,137.44) | (8.25) | (36.76) |
| Vushtrri | 3,418,154.00 | 2,981,539.03 | 87.23 | 3,525,467.00 | 3,862,642.05 | 109.56 | 107,313.00 | 3.14 | 881,103.02 | 29.55 | 22.34 |
| Zubin Potok | 68,072.00 | 4,522.00 | 6.64 | 68,072.00 | 15,686.90 | 23.04 | - | - | 11,164.90 | 246.90 | 16.40 |
| Zveçan | 62,021.00 | 6,928.50 | 11.17 | 66,702.00 | 8,816.32 | 13.22 | 4,681.00 | 7.55 | 1,887.82 | 27.25 | 2.05 |
| Mitrovicë Veri | 90,000.00 | 99,595.50 | 110.66 | 106,157.00 | 202,047.47 | 190.33 | 16,157.00 | 17.95 | 102,451.97 | 102.87 | 79.67 |
| Gjilan | 5,038,508.00 | 4,367,252.58 | 86.68 | 5,038,508.00 | 4,964,897.99 | 98.54 | - | - | 597,645.41 | 13.68 | 11.86 |
| Kaçanik | 924,200.00 | 743,893.38 | 80.49 | 950,401.00 | 802,067.62 | 84.39 | 26,201.00 | 2.83 | 58,174.24 | 7.82 | 3.90 |
| Kamenicë | 1,016,621.00 | 741,531.31 | 72.94 | 1,134,072.00 | 933,432.09 | 82.31 | 117,451.00 | 11.55 | 191,900.78 | 25.88 | 9.37 |
| Novobërdë | 313,845.00 | 499,233.23 | 159.07 | 432,758.00 | 520,988.19 | 120.39 | 118,913.00 | 37.89 | 21,754.96 | 4.36 | (38.68) |
| Shtërpcë | 391,317.00 | 316,083.75 | 80.77 | 403,713.00 | 303,020.39 | 75.06 | 12,396.00 | 3.17 | (13,063.36) | (4.13) | (5.72) |
| Ferizaj | 5,409,728.00 | 6,194,484.18 | 114.51 | 7,974,306.00 | 8,652,757.74 | 108.51 | 2,564,578.00 | 47.41 | 2,458,273.56 | 39.68 | (6.00) |
| Viti | 1,029,502.00 | 941,055.85 | 91.41 | 1,270,127.00 | 1,278,947.50 | 100.69 | 240,625.00 | 23.37 | 337,891.65 | 35.91 | 9.29 |
| Partesh | 171,594.00 | 264,766.57 | 154.30 | 244,251.00 | 230,294.81 | 94.29 | 72,657.00 | 42.34 | (34,471.76) | (13.02) | (60.01) |
| Hani I Elezit | 274,376.00 | 253,529.64 | 92.40 | 339,719.00 | 1,148,948.98 | 338.21 | 65,343.00 | 23.82 | 895,419.34 | 353.18 | 245.80 |
| Kllokot | 194,046.00 | 124,639.06 | 64.23 | 198,114.00 | 122,250.18 | 61.71 | 4,068.00 | 2.10 | (2,388.88) | (1.92) | (2.52) |
| Ranillugë | 107,898.00 | 132,265.02 | 122.58 | 106,698.00 | 136,832.90 | 128.24 | (1,200.00) | (1.11) | 4,567.88 | 3.45 | 5.66 |
| Gjithsej | **105,523,577.00** | **99,583,077.74** | **94.37** | **114,283,838.00** | **121,572,826.59** | **106.38** | **8,760,261.00** | **8.30** | **21,989,748.85** | **22.08** | **12.01** |

Në tabelën e dytë vërehen lëvizje të shumta nëpër komuna në realizimin e të hyrave në krahasim me vitin paraprak. Në tabelë mund të shihet se disa komuna kanë rritje të përqindjes së realizimit të të hyrave vetanake në vitin 2025, në krahasim me vitin 2024, ndërsa disa komuna kanë zvogëlim të të hyrave vetanake. .

## REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE TE KOMUNAVE SIPAS STRUKTURËS PËR VITIN 2025 dhe 2024

| | Komunat | Tatimi në Pronë | | Regjistrimi I Automjeteve | | Të hyrat komunale për leje ndërtimi | | Të hyrat nga regjistrimin I Trashegimis | | Të hyrat nga ndrrimi I Destinimit Tokës | | Të Hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile | | Të hyrat nga bizneset | | Të hyrat nga shfrytezimi I prones publike | | Të hyrat nga participimet në Arsim dhe Shendetësi | | Të hyrat e tjera | | Totali I I realizmit te hyrave vetanake direkte | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Viti 2024-2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 | 2024 | 2025 |
| 1 | Gllogovc | 383,330.32 | 487,828.50 | 144,907.00 | 159,655.00 | 569,983.33 | 470,525.91 | 66,876.00 | 57,805.50 | 26,251.60 | 70,141.40 | 54,330.63 | 44,642.18 | 296,082.14 | 165,200.00 | 50,358.44 | 83,496.34 | 88,167.50 | 94,867.50 | 38,600.05 | 44,456.90 | 1,718,887.01 | 1,678,619.23 |
| 2 | Fushë | 1,516,262.64 | 1,696,093.37 | 165,551.00 | 188,500.00 | 1,699,722.40 | 2,161,627.94 | 83,329.24 | 86,581.50 | 181,450.89 | 118,527.00 | 67,183.85 | 41,944.50 | - | 1.00 | 8,825.88 | 41,288.28 | 122,575.47 | 244,960.50 | 194,303.59 | 237,920.85 | 4,039,204.96 | 4,817,444.94 |
| 3 | Lipjan | 1,360,881.14 | 1,399,261.36 | 173,007.00 | 193,820.00 | 923,558.44 | 950,035.50 | 84,724.00 | 65,373.00 | 109,633.95 | 205,602.60 | 42,521.00 | 50,208.00 | 3,150.00 | 5,865.00 | 152,206.32 | 120,477.29 | 166,352.00 | 253,620.00 | 119,770.43 | 141,388.12 | 3,135,804.28 | 3,385,650.87 |
| 4 | Obiliq | 445,529.96 | 545,499.92 | 71,545.00 | 79,370.00 | 20,322.98 | 371,394.33 | 51,316.10 | 47,903.00 | 700.00 | 50,896.06 | 21,499.00 | 20,569.00 | 130,499.84 | 117,493.82 | 24,913.01 | 34,927.68 | 145,309.70 | 159,453.20 | 5,895.40 | 56,817.33 | 917,530.99 | 1,484,324.34 |
| 5 | Podujevë | 347,282.93 | 574,485.37 | 205,126.50 | 228,215.00 | 437,016.32 | 586,094.75 | - | - | 67,293.72 | 50,564.26 | 81,144.00 | 77,780.00 | 4,295.15 | 2,445.76 | 54,244.31 | 104,649.28 | 263,705.64 | 256,137.68 | 250,905.38 | 273,043.78 | 1,711,013.95 | 2,153,415.88 |
| 6 | Prishtinë | 8,645,724.03 | 11,316,301.06 | 918,897.60 | 1,004,723.84 | 12,599,925.13 | 21,235,371.27 | - | - | 1,337,701.96 | 1,130,474.00 | 198,841.53 | 203,551.20 | 187,519.68 | 283,511.09 | 3,198,538.99 | 3,601,828.86 | 1,388,338.71 | 1,504,317.93 | 3,920,435.01 | 3,102,032.55 | 32,395,922.64 | 43,382,111.80 |
| 7 | Shtime | 221,528.04 | 320,036.43 | 71,316.00 | 76,810.00 | 35,304.50 | 92,986.68 | 24,259.00 | 17,525.00 | 7,016.75 | 36,053.00 | 34,047.00 | 33,484.00 | - | - | 56,150.33 | 46,429.88 | 98,114.60 | 106,860.30 | 10,325.35 | 24,859.61 | 558,061.57 | 755,044.90 |
| 8 | Graçanicë | 1,244,957.67 | 1,227,677.95 | 80,535.00 | 93,135.00 | 455,491.12 | 640,971.06 | 70,970.00 | 42,840.00 | 451,044.50 | 462,945.50 | 13,739.00 | 13,398.00 | 5,838.00 | 2,250.00 | 78,787.86 | 47,195.93 | 15,316.50 | 12,357.00 | 100,565.55 | 84,313.23 | 2,517,245.20 | 2,627,083.67 |
| 9 | Dragash | 251,995.66 | 271,410.00 | 53,812.01 | 56,591.01 | 21,033.62 | 38,782.99 | 5,329.00 | 1,939.00 | - | - | 64,565.01 | 57,374.00 | 230.00 | - | 38,007.71 | 43,112.35 | 805.02 | 747.00 | 6,518.17 | 2,604.46 | 442,296.20 | 472,560.81 |
| 10 | Prizren | 2,515,848.43 | 2,871,065.44 | 415,261.70 | 469,939.18 | 2,887,836.41 | 2,966,176.46 | 193,516.00 | 161,111.00 | - | - | 214,555.50 | 164,271.00 | 8,047.00 | 43,809.10 | 361,071.08 | 398,691.60 | 383,642.80 | 491,119.91 | 1,431,433.44 | 1,848,762.81 | 8,411,212.36 | 9,414,946.50 |
| 11 | Rahovec | 993,629.45 | 1,060,710.71 | 121,025.00 | 130,044.00 | 65,872.66 | 117,868.32 | 30,000.00 | 39,655.00 | 480.00 | 324,749.93 | 74,823.00 | 74,038.40 | 94,944.90 | 59,614.00 | 180,687.76 | 157,224.34 | 222,073.63 | 176,106.80 | 79,540.54 | 70,457.98 | 1,863,076.94 | 2,210,469.48 |
| 12 | Suharekë | 544,388.60 | 837,186.00 | 175,949.00 | 193,571.00 | 892,858.25 | 489,077.36 | - | 5,252.00 | - | - | 71,216.75 | 51,207.10 | 153,849.68 | 122,929.29 | 317,758.87 | 276,117.02 | 147,463.90 | 207,173.80 | 153,610.59 | 91,171.91 | 2,457,095.64 | 2,273,685.48 |
| 13 | Malishevë | 748,260.74 | 705,347.84 | 121,437.00 | 129,110.00 | 499,456.14 | 693,230.51 | 20,779.00 | 23,827.00 | 67,089.00 | 45,523.40 | 56,343.36 | 49,875.70 | 19,665.00 | 3,870.00 | 83,322.64 | 36,145.44 | 158,745.80 | 171,668.90 | 132,595.01 | 133,083.24 | 1,907,693.69 | 1,991,682.03 |
| 14 | Mamushë | 53,879.72 | 48,197.56 | 11,705.00 | 13,505.00 | 1,268.77 | - | - | - | - | - | 4,917.50 | 5,641.50 | 384.00 | 1,564.00 | - | - | 3,992.50 | 3,225.50 | 7,181.00 | 11,299.00 | 83,328.49 | 83,432.56 |
| 15 | Deçan | 520,053.85 | 397,617.37 | 95,245.00 | 101,871.00 | 82,392.12 | 244,254.71 | - | - | 65,635.50 | 46,217.00 | 32,544.03 | 26,044.54 | 1,480.00 | 1,590.00 | 2,735.50 | 375.00 | 6,864.00 | 6,184.00 | 64,250.24 | 82,334.41 | 871,200.24 | 906,488.03 |
| 16 | Gjakovë | 2,309,844.25 | 2,429,593.73 | 247,920.00 | 264,578.00 | 1,833,974.72 | 1,331,566.26 | 29,008.49 | 14,229.41 | 64,484.43 | 84,484.75 | 125,935.50 | 93,573.36 | 171,381.25 | 185,904.50 | 454,613.48 | 389,557.70 | 512,736.35 | 528,026.70 | 119,793.54 | 132,491.56 | 5,869,692.01 | 5,454,005.97 |
| 17 | Istog | 492,112.86 | 725,139.01 | 116,555.00 | 127,070.00 | 744,389.67 | 479,390.06 | - | - | 67,800.41 | 510,721.91 | 55,891.50 | 59,592.00 | 3,880.00 | 4,870.00 | 186,356.25 | 116,096.40 | 167,892.13 | 163,372.83 | 92,579.07 | 58,354.47 | 1,927,456.89 | 2,244,606.68 |
| 18 | Klinë | 551,021.23 | 586,707.52 | 93,654.92 | 101,354.50 | 300,941.13 | 333,070.27 | - | - | - | - | 49,136.00 | 127,745.77 | 68,433.28 | 45,672.00 | 87,258.55 | 86,939.54 | 120,256.00 | 116,024.50 | 19,061.96 | 14,239.72 | 1,289,763.07 | 1,411,753.82 |
| 19 | Pejë | 2,208,682.69 | 2,218,775.42 | 287,657.00 | 313,085.00 | 1,340,236.90 | 1,820,755.95 | 132,612.00 | 105,026.00 | 18,919.70 | 496,564.39 | 155,888.00 | 132,055.00 | 55,420.00 | 27,001.00 | 787,727.95 | 1,069,721.09 | 308,137.70 | 364,343.30 | 44,007.28 | 20,956.28 | 5,339,289.22 | 6,568,283.43 |
| 20 | Junik | 98,143.77 | 101,771.64 | 9,115.00 | 9,330.00 | 6,451.51 | 5,683.86 | 8,113.00 | 8,538.47 | 2,410.65 | 2,016.00 | 6,083.00 | 5,493.90 | 9,148.00 | 8,231.00 | 9,714.20 | 4,019.00 | 6,073.00 | 6,030.50 | 1,552.00 | 30.00 | 156,804.13 | 151,144.37 |
| 21 | Leposaviq | - | 547.61 | - | - | - | - | - | - | - | - | 4,117.00 | 12,069.00 | - | - | - | - | - | - | 6,348.00 | 15,622.00 | 10,465.00 | 28,238.61 |
| 22 | Mitrovicë | 1,174,736.88 | 1,225,952.39 | 170,315.00 | 187,050.00 | 644,355.39 | 1,295,069.49 | 92,134.00 | 74,093.00 | 7,204.00 | 34,516.76 | 106,098.03 | 90,782.54 | 14,663.10 | 48,497.50 | 244,886.80 | 213,822.85 | 180,878.00 | 181,019.50 | 75,142.49 | 95,234.50 | 2,710,413.69 | 3,446,038.53 |
| 23 | Skenderaj | 217,509.29 | 288,441.64 | 106,626.00 | 113,307.00 | 587,072.04 | 403,721.49 | 39,151.00 | 37,363.00 | 89,914.83 | 1,465.00 | 49,474.00 | 43,778.00 | 30,725.00 | 24,730.00 | 260,543.15 | 337,784.29 | 99,252.80 | 128,759.40 | 98,032.86 | 68,813.71 | 1,578,300.97 | 1,448,163.53 |
| 24 | Vushtrri | 665,404.75 | 934,903.33 | 170,835.00 | 189,680.00 | 764,122.29 | 1,244,542.27 | - | - | 140,228.55 | 133,512.81 | 36,042.00 | 48,109.50 | 33,511.50 | 31,219.50 | 145,415.55 | 155,319.60 | 228,917.00 | 267,739.00 | 797,062.39 | 857,616.04 | 2,981,539.03 | 3,862,642.05 |
| 25 | Zubin Potok | - | 130.30 | - | - | - | 8,091.60 | - | - | - | - | 4,522.00 | 7,465.00 | - | - | - | - | - | - | - | - | 4,522.00 | 15,686.90 |
| 26 | Zveçan | - | 43.36 | - | - | - | - | - | - | - | - | 3,955.50 | 4,503.00 | - | - | - | - | - | - | 2,973.00 | 4,269.96 | 6,928.50 | 8,816.32 |
| 27 | Mitrovicë | - | 8,336.82 | 18,626.00 | 19,565.00 | 2,399.50 | 57,672.25 | 12,948.00 | 10,710.00 | - | 19,786.25 | 17,471.00 | 16,367.00 | - | - | 37,393.00 | 56,097.39 | - | - | 10,758.00 | 13,512.76 | 99,595.50 | 202,047.47 |
| 28 | Gjilan | 1,621,438.91 | 2,361,986.96 | 259,230.00 | 268,623.00 | 1,168,630.37 | 1,103,002.32 | - | - | 82,561.75 | 46,612.75 | 107,950.00 | 88,265.50 | 1,862.50 | 16,656.00 | 458,042.76 | 371,860.97 | 422,069.30 | 414,834.10 | 245,466.99 | 293,056.39 | 4,367,252.58 | 4,964,897.99 |
| 29 | Kaçanik | 310,632.83 | 271,644.75 | 79,430.50 | 87,416.00 | 60,155.42 | 180,406.33 | - | 991.90 | 61,913.40 | 19,824.55 | 25,758.79 | 25,385.20 | 360.00 | - | 57,573.77 | 52,976.73 | 55,021.00 | 73,199.50 | 93,047.67 | 90,222.66 | 743,893.38 | 802,067.62 |
| 30 | Kamenicë | 300,251.75 | 431,023.89 | 78,539.50 | 82,231.00 | 25,610.70 | 59,115.00 | 28,761.00 | 30,030.00 | - | 2,710.68 | 29,875.00 | 31,448.50 | 78,002.10 | 76,640.54 | 60,246.77 | 62,395.41 | 111,321.80 | 129,912.50 | 28,922.69 | 27,924.57 | 741,531.31 | 933,432.09 |
| 31 | Novobërdë | 188,639.17 | 277,920.11 | 19,215.00 | 20,945.00 | 86,572.58 | 35,835.47 | 1,000.00 | 1,710.00 | 164,945.47 | 152,824.35 | 6,761.00 | 4,518.00 | 7,607.00 | 207.00 | 6,666.00 | 10,175.00 | 2,099.60 | 2,028.60 | 15,727.41 | 14,824.66 | 499,233.23 | 520,988.19 |
| 32 | Shtërpcë | 228,670.29 | 232,039.47 | 25,711.00 | 27,450.00 | 4,148.56 | 2,263.32 | 33,266.00 | 27,081.00 | - | - | 5,051.00 | 5,685.00 | - | - | - | - | 1,645.90 | 1,177.10 | 17,591.00 | 7,324.50 | 316,083.75 | 303,020.39 |
| 33 | Ferizaj | 2,142,214.12 | 2,371,732.22 | 372,320.00 | 430,027.33 | 2,450,041.31 | 4,895,869.16 | - | - | - | - | 103,937.00 | 91,335.50 | 2,680.00 | 4,310.00 | 484,018.32 | 302,940.40 | 349,951.70 | 291,115.80 | 289,321.73 | 265,427.33 | 6,194,484.18 | 8,652,757.74 |
| 34 | Viti | 450,548.14 | 676,177.72 | 127,766.00 | 138,355.50 | 50,972.19 | 106,550.84 | 51,152.00 | 54,585.00 | 4,028.25 | 10,191.75 | 45,379.00 | 39,211.00 | 2,730.00 | 5,012.50 | 59,922.00 | 67,342.27 | 123,364.70 | 153,327.00 | 25,193.57 | 28,193.92 | 941,055.85 | 1,278,947.50 |
| 35 | Partesh | 77,693.96 | 70,038.52 | 6,381.00 | 6,913.57 | 83,826.75 | 91,640.30 | 3,545.89 | 1,309.00 | 57,445.02 | 23,627.09 | 6,441.10 | 10,763.68 | - | - | 773.80 | - | - | - | 28,659.05 | 26,002.65 | 264,766.57 | 230,294.81 |
| 36 | Hani I Elezit | 78,409.87 | 78,416.21 | 23,933.00 | 24,565.00 | 11,141.84 | 4,158.21 | 6,100.00 | 4,950.00 | 241.00 | 908,571.71 | 5,382.50 | 2,510.50 | 78,016.88 | 76,170.80 | 11,240.10 | 13,407.65 | 24,078.20 | 26,260.95 | 14,986.25 | 9,937.95 | 253,529.64 | 1,148,948.98 |
| 37 | Kllokot | 50,103.32 | 53,960.27 | 8,540.00 | 10,160.00 | 6.00 | 3,824.91 | 6,434.00 | 5,679.00 | 13,271.00 | 6,307.00 | 2,169.00 | 1,705.00 | 1,261.00 | 40.00 | 26,169.12 | 36,195.00 | - | - | 16,685.62 | 4,379.00 | 124,639.06 | 122,250.18 |
| 38 | Ranillug | 54,843.31 | 73,937.14 | 8,810.00 | 9,295.00 | 8,260.70 | 5,841.94 | 5,790.00 | 8,120.00 | 2,858.50 | 1,288.00 | 3,455.00 | 7,595.00 | 8,425.00 | 11,067.50 | 5,066.46 | 3,309.92 | - | - | 34,756.05 | 16,378.40 | 132,265.02 | 136,832.90 |
| | **TOTALI** | **33,014,454.57** | **39,177,938.91** | **5,056,499.73** | **5,549,860.93** | **31,365,351.76** | **44,526,469.09** | **1,081,113.72** | **934,227.78** | **3,092,524.83** | **4,996,719.90** | **1,989,044.08** | **1,863,986.07** | **1,474,092.00** | **1,376,372.90** | **7,991,236.73** | **8,341,920.50** | **5,925,162.95** | **6,535,971.30** | **8,593,598.37** | **8,269,359.21** | **99,583,078.74** | **121,572,826.59** |

Në tabelën e tretë është paraqitur grumbullimi i të hyrave sipas strukturës. Ku përqindja me e madhe e grumbullimit të hyrave vetanake është në të hyrat komunale për leje ndërtimi me **44,526,469.09€,** pastaj tatimin në pronë me **39,177,938.91€.**

*Shtojca nr.3 – Të hyrat sipas strukturës të shprehur në përqindje.*

| Pjesëmarrja e të hyrave sipas strukturës | | |
|---|---|---|
| Tatimi në Pronë | 39,177,938.91 | 32.23 |
| Regjistrimi i Automjeteve | 5,549,860.93 | 4.57 |
| Të hyrat komunale për leje ndërtimi | 44,526,469.09 | 36.63 |
| Të hyrat nga regjistrimin i Trashëgimisë | 934,227.78 | 0.77 |
| Të hyrat nga ndërrimi i Destinimit Tokës | 4,996,719.90 | 4.11 |
| Të Hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile | 1,863,986.07 | 1.53 |
| Të hyrat nga bizneset | 1,376,372.90 | 1.13 |
| Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike | 8,341,920.50 | 6.86 |
| Të hyrat nga participimet në Arsim dhe Shëndetësi | 6,535,971.30 | 5.38 |
| Të hyrat e tjera | 8,269,359.21 | 6.80 |
| **Totali i realizmit të të hyrave vetanake** | **121,572,826.59** | **100.00** |

*Shtojca nr.4 – Struktura e të hyrave vetanake.*



*Shtojca nr. 5 – Të hyrat direkte dhe indireke për vitin 2025.*

| Komunat | Planifikimi I të hyrave vetanake | Realizimi i të hyrave për vitin 2025 | | | | | Gjithsej realizimi i të hyrave | % e realizmit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Të hyrat direkte | Te hyrat indirekte | | | | | |
| | | | Të hyrat nga gjykatat | Të hyrat nga gjobat ne trafik | Të hyrat nga licencat për pyje | Totali i të hyrave indirekte | | |
| Gllogovc | 1,936,467.00 | 1,678,619.23 | 78,558.50 | 984,434.50 | - | 1,062,993.00 | 2,741,612.23 | 141.58 |
| Fushë Kosovë | 3,459,675.00 | 4,817,444.94 | 105,305.00 | 1,183,933.00 | - | 1,289,238.00 | 6,106,682.94 | 176.51 |
| Lipjan | 3,174,047.00 | 3,385,650.87 | 51,390.00 | 486,514.00 | 216.90 | 538,120.90 | 3,923,771.77 | 123.62 |
| Obiliq | 1,291,588.00 | 1,484,324.34 | - | 402,518.00 | - | 402,518.00 | 1,886,842.34 | 146.09 |
| Podujevë | 1,986,336.00 | 2,153,415.88 | 39,470.00 | 612,855.00 | 165.64 | 652,490.64 | 2,805,906.52 | 141.26 |
| Prishtinë | 38,778,968.00 | 43,382,111.80 | 215,215.00 | 6,255,626.36 | 2,579.95 | 6,473,421.31 | 49,855,533.11 | 128.56 |
| Shtime | 858,258.00 | 755,044.90 | - | 224,808.00 | - | 224,808.00 | 979,852.90 | 114.17 |
| Graçanicë | 2,729,206.00 | 2,627,083.67 | 21,825.00 | 401,276.00 | - | 423,101.00 | 3,050,184.67 | 111.76 |
| Dragash | 551,054.00 | 472,560.81 | 2,260.00 | 82,197.00 | 14,041.69 | 98,498.69 | 571,059.50 | 103.63 |
| Prizren | 10,600,777.00 | 9,414,946.50 | 121,515.00 | 2,654,173.00 | 15,380.87 | 2,791,068.87 | 12,206,015.37 | 115.14 |
| Rahovec | 2,001,711.00 | 2,210,469.48 | 34,811.92 | 398,604.00 | 198.40 | 433,614.32 | 2,644,083.80 | 132.09 |
| Suharekë | 2,401,424.00 | 2,273,685.48 | 37,940.00 | 689,240.00 | 3,627.91 | 730,807.91 | 3,004,493.39 | 125.11 |
| Malishevë | 1,505,526.00 | 1,991,682.03 | 60,095.73 | 522,754.00 | - | 582,849.73 | 2,574,531.76 | 171.01 |
| Mamushë | 98,782.00 | 83,432.56 | - | 19,001.00 | - | 19,001.00 | 102,433.56 | 103.70 |
| Deçan | 900,571.00 | 906,488.03 | 12,705.00 | 154,793.00 | - | 167,498.00 | 1,073,986.03 | 119.26 |
| Gjakovë | 5,934,237.00 | 5,454,005.97 | 98,294.84 | 1,521,966.50 | - | 1,620,261.34 | 7,074,267.31 | 119.21 |
| Istog | 1,496,509.00 | 2,244,606.68 | 48,045.00 | 349,918.00 | 6,333.93 | 404,296.93 | 2,648,903.61 | 177.01 |
| Klinë | 1,495,504.00 | 1,411,753.82 | 15,555.00 | 628,425.00 | - | 643,980.00 | 2,055,733.82 | 137.46 |
| Pejë | 5,593,510.00 | 6,568,283.43 | 85,055.48 | 1,148,813.81 | - | 1,233,869.29 | 7,802,152.72 | 139.49 |
| Junik | 204,942.00 | 151,144.37 | - | 15,355.00 | - | 15,355.00 | 166,499.37 | 81.24 |
| Leposaviq | 100,720.00 | 28,238.61 | - | 110,711.00 | - | 110,711.00 | 138,949.61 | 137.96 |
| Mitrovicë | 3,615,495.00 | 3,446,038.53 | 98,050.00 | 444,483.00 | 741.58 | 543,274.58 | 3,989,313.11 | 110.34 |
| Skenderaj | 1,709,466.00 | 1,448,163.53 | 40,350.00 | 278,866.00 | 441.56 | 319,657.56 | 1,767,821.09 | 103.41 |
| Vushtrri | 3,525,467.00 | 3,862,642.05 | 44,790.00 | 668,198.00 | 907.08 | 713,895.08 | 4,576,537.13 | 129.81 |
| Zubin Potok | 68,072.00 | 15,686.90 | - | 111,088.00 | - | 111,088.00 | 126,774.90 | 186.24 |
| Zveçan | 66,702.00 | 8,816.32 | - | 105,191.50 | - | 105,191.50 | 114,007.82 | 170.92 |
| Mitrovicë Veriore | 106,157.00 | 202,047.47 | - | 3,970.00 | - | 3,970.00 | 206,017.47 | 194.07 |
| Gjilan | 5,038,508.00 | 4,964,897.99 | 70,275.00 | 1,254,469.00 | 1,543.04 | 1,326,287.04 | 6,291,185.03 | 124.86 |
| Kaçanik | 950,401.00 | 802,067.62 | 18,402.00 | 210,387.00 | 9,096.92 | 237,885.92 | 1,039,953.54 | 109.42 |
| Kamenicë | 1,134,072.00 | 933,432.09 | 6,780.00 | 251,628.00 | 49,960.19 | 308,368.19 | 1,241,800.28 | 109.50 |
| Novobërdë | 432,758.00 | 520,988.19 | 7,400.00 | 116,736.00 | 15,423.94 | 139,559.94 | 660,548.13 | 152.64 |
| Shtërpcë | 403,713.00 | 303,020.39 | 8,540.00 | 67,710.00 | 4,679.02 | 80,929.02 | 383,949.41 | 95.10 |
| Ferizaj | 7,974,306.00 | 8,652,757.74 | 118,035.00 | 1,727,283.00 | 6,865.36 | 1,852,183.36 | 10,504,941.10 | 131.73 |
| Viti | 1,270,127.00 | 1,278,947.50 | 26,450.00 | 271,142.00 | 0.00 | 297,592.00 | 1,576,539.50 | 124.12 |
| Partesh | 244,251.00 | 230,294.81 | - | 16,350.00 | - | 16,350.00 | 246,644.81 | 100.98 |
| Hani I Elezit | 339,719.00 | 1,148,948.98 | - | 119,370.00 | 198.75 | 119,568.75 | 1,268,517.73 | 373.40 |
| Kllokot | 198,114.00 | 122,250.18 | - | 24,235.00 | - | 24,235.00 | 146,485.18 | 73.94 |
| Ranillugë | 106,698.00 | 136,832.90 | - | 25,981.00 | - | 25,981.00 | 162,813.90 | 152.59 |
| **Totali** | **114,283,838.00** | **121,572,826.59** | **1,467,113.47** | **24,545,003.67** | **132,402.73** | **26,144,519.87** | **147,717,346.46** | **129.25** |

Në këtë tabelë janë paraqitur të hyrat direkte që mblidhen nga niveli komunal dhe të hyrat indirekte që mblidhen nga niveli qendror dhe i kthehen nivelit lokal. Si te hyra direkte për vitin 2025 janë **121,572,826.59€,** kurse të hyra inirekte **26,144,519.87€.** Në total të hyrat e grumbulluara për vitin 2025 janë **147,717,346.46€.**

*Shtojca nr.6 – % e realizimit të hyrave vetanake për vitin 2025.*




**Referenca:** Shënimet nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës-SIMFK nga Ministria e Financave Punës dhe Transferëve / Departamenti i Thesarit të datës 09.03.2026.

## BUXHETIMI KOMUNAL PËR VITIN 2025

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2025 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej **837,642,279.69 €** ose **96.92 %** e buxhetit të planifikuar në vlerë prej **864,227,543.13 €.**

Bazuar në gjendjen e fundit të raporteve vjetore në SIMFK, për vitin 2025, komunat e Kosovës kanë pasur në dispozicion buxhetin në shumë prej **864,227,543.13€** apo **23,186,897.14 €,** më shumë krahasuar me vitin 2024 sa ishte **841,040,645.99 €.**

Ndërsa nëse krahasojmë buxhetin dhe shpenzimet në mes të vitit 2024 dhe 2025 vërejmë:

*Shtojca nr. 7 – Pasqyra e shpenzimeve komunale për vitin 2025 dhe krahasimi me vitin 2024*

| Pasqyra e shpenzimeve komunale për vitin 2025 dhe krahasimi me vitin 2024 | | | | | | | Krahasimi I Buxhetit 2025/2024 | | Krahasimi i Shpenzimeve 2025/2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komunat | Shpenzimet 2024 | | | Shpenzimet 2025 | | | | | | |
| | Buxheti 2024 | Shpenzimet 2024 | % e realizimit | Buxheti 2025 | Shpenzimet 2025 | % e realizimit | krahasimi 2025-2024 në vlerë | krahasimi 2025-2024 në % | krahasimi 2025-2024 në vlerë | krahasimi 2025-2024 në % |
| Paga dhe shtesa | 381,092,179.59 | 380,868,004.81 | 99.94 | 396,207,995.06 | 393,562,841.13 | 99.33 | 15,115,815.47 | 3.97 | 12,694,836.32 | 3.33 |
| Mallrat dhe shebimet | 124,781,063.81 | 121,633,403.95 | 97.48 | 138,672,867.76 | 135,108,751.88 | 97.43 | 13,891,803.95 | 11.13 | 13,475,347.93 | 11.08 |
| Shpenzimet komunale | 15,600,287.60 | 14,531,182.27 | 93.15 | 16,526,679.32 | 16,001,135.29 | 96.82 | 926,391.72 | 5.94 | 1,469,953.02 | 10.12 |
| Subvencione dhe transfere | 34,088,682.80 | 32,580,056.50 | 95.57 | 38,760,527.08 | 37,353,529.47 | 96.37 | 4,671,844.28 | 13.70 | 4,773,472.97 | 14.65 |
| Shpenzimet kapitale(pasurit jo financ) | 285,478,432.19 | 234,919,807.86 | 82.29 | 273,820,027.91 | 255,616,021.92 | 93.35 | (11,658,404.28) | (4.08) | 20,696,214.06 | 8.81 |
| Rezervat | | | | 239,446.00 | - | - | 239,446.00 | #DIV/0! | - | #DIV/0! |
| **TOTALI** | **841,040,645.99** | **784,532,455.39** | **93.28** | **864,227,543.13** | **837,642,279.69** | **96.92** | **23,186,897.14** | **2.76** | **53,109,824.30** | **6.77** |

Në vitin 2024, buxheti i përgjithshëm në vlerë prej 841,040,645.99 € dhe është shpenzuar 784,532,455.39 € ose 93.28 % e buxhetit.

Sipas kategorive ekonomike në përgjithësi buxheti i komunave në vitin 2025 është shpenzuar si vijon: kategoria e pagave dhe shtesave **99.94%,** kategoria e mallrave dhe shërbimeve **97.48%,** shpenzimet komunale të **93.15%,** subvencione dhe transfere **95.57%,** dhe kategoria e shpenzimeve kapitale **82.29%**, (kategoria më së paku e shpenzuar).

Në vitin 2025 buxheti i përgjithshëm ishte **864,227,543.13 €** që do të thotë për **23,186,897.14 €,** ose **2.76%** më i madh se në vitin 2024, i cili ishte **841,040,645.99 €.**

Shpenzimet në vitin 2025 janë në vlerë prej **837,642,279.69 €** ose për **53,109,824.30€** më shumë së sa në vitin 2024 të cilat ishin **784,532,455.39 €** ose shprehur në % më shumë për **6.77%.**

Sipas kategorive ekonomike buxheti i komunave në vitin 2025 është shpenzuar si vijon:

- Kategoria e pagave dhe shtesave në vitin 2025 është planifikuar në vlerë prej 396,207,995.06 €, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 393,562,841.13€, ose 99.33%,
- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është planifikuar në vlerë prej 138,672,867.76€ ndërsa është shpenzuar në vlere prej 135,108,751.88€ ose 97.43 %,
- Shpenzimet komunale të planifikuara në shumë prej 16,526,679.32€, janë shpenzuar 16,001,135.29€, ose 96.82%,
- Subvencione dhe transfere të planifikuara në shumë prej 38,760,527.08€, janë shpenzuar 37,353,529.47€ ose 96.37%,
- Kategoria e shpenzimeve kapitale të planifikuara në shumë prej 273,820,027.91€, dhe janë shpenzuar 255,616,021.92€, ose 93.95%,
- Kategoria e rezervave të planifikuara në shumë prej 239,446.00€ nuk është shpenzuar fare(0.00%).

Nëse bëjmë krahasimin në mes të kategorive ekonomike vërejmë se në vitin 2025, në kategorinë pagave dhe shtesave është shpenzuar 12,694,836.32 € me shume se në vitin 2024; në kategorinë e mallrave dhe shërbime në vitin 2025 është shpenzuar 13,475,347.93€ me shumë; në kategorinë e shpenzimeve komunale janë shpenzuar 1,469,523.02 € më shumë në krahasim me vitin 2024; në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve janë shpenzuar 4,773,472.97€ me shumë në krahasim

me vitin 2024 dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë shpenzuar 20,696,214.06€ më shumë në vitin 2024. Krahasimi i buxhetin dhe shpenzimet në mes të vitit 2024 dhe 2025 është pasqyruar në tabelën në vijim:

*Shtojca nr. 8 – Krahasimi i buxhetin dhe shpenzimet në mes të vitit 2024 dhe 2025.*

| Pasqyra e shpenzimeve komunale për vitin 2025 dhe krahasimi me vitin 2024 | | | | | | | Krahasimi Buxhetit 2025/2024 | | Krahasimei Shpenzimeve 2025/2024 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komunat | Shpenzimet 2024 | | | Shpenzimet 2025 | | | | | | |
| | Buxheti 2024 | Shpenzimet 2024 | % e realizimit | Buxheti 2025 | Shpenzimet 2025 | % e realizimit | krahasimi 2025-2024 në vlerë | krahasimi 2025-2024 në % | krahasimi 2025-2024 në vlerë | krahasimi 2025-2024 në % |
| Gllogovc | 23,622,785.42 | 22,153,082.99 | 93.78 | 23,964,349.97 | 23,251,146.87 | 97.02 | 341,564.55 | 1.45 | 1,098,063.88 | 4.96 |
| Fushë Kosovë | 23,747,556.72 | 20,770,493.81 | 87.46 | 22,297,951.94 | 20,159,728.69 | 90.41 | (1,449,604.78) | (6.10) | (610,765.12) | (2.94) |
| Lipjan | 25,223,733.89 | 24,660,049.15 | 97.77 | 27,335,092.10 | 25,861,901.33 | 94.61 | 2,111,358.21 | 8.37 | 1,201,852.18 | 4.87 |
| Obiliq | 14,612,754.36 | 14,379,435.05 | 98.40 | 15,304,250.76 | 15,247,030.58 | 99.63 | 691,496.40 | 4.73 | 867,595.53 | 6.03 |
| Podujevë | 33,816,157.46 | 33,114,654.84 | 97.93 | 36,081,020.43 | 35,341,907.62 | 97.95 | 2,264,862.97 | 6.70 | 2,227,252.78 | 6.73 |
| Prishtinë | 170,702,510.22 | 137,213,244.93 | 80.38 | 158,338,868.85 | 157,342,545.11 | 99.37 | (12,363,641.37) | (7.24) | 20,129,300.18 | 14.67 |
| Shtime | 10,859,984.30 | 10,659,398.65 | 98.15 | 11,485,299.16 | 11,285,452.89 | 98.26 | 625,314.86 | 5.76 | 626,054.24 | 5.87 |
| Graçanicë | 9,886,126.37 | 9,316,993.80 | 94.24 | 10,824,417.15 | 9,848,543.78 | 90.98 | 938,290.78 | 9.49 | 531,549.98 | 5.71 |
| Dragash | 12,336,546.44 | 12,192,220.37 | 98.83 | 13,380,396.54 | 12,757,807.80 | 95.35 | 1,043,850.10 | 8.46 | 565,587.43 | 4.64 |
| Prizren | 69,441,123.07 | 67,996,154.02 | 97.92 | 73,867,538.45 | 72,046,839.53 | 97.54 | 4,426,415.38 | 6.37 | 4,050,685.51 | 5.96 |
| Rahovec | 21,801,773.87 | 21,695,290.60 | 99.51 | 22,660,271.22 | 22,657,300.17 | 99.99 | 858,497.35 | 3.94 | 962,009.57 | 4.43 |
| Suharekë | 24,818,347.88 | 24,620,015.81 | 99.20 | 24,973,907.00 | 24,520,388.84 | 98.18 | 155,559.12 | 0.63 | (99,626.97) | (0.40) |
| Malishevë | 21,701,931.29 | 21,618,284.17 | 99.61 | 22,745,306.09 | 22,535,954.51 | 99.08 | 1,043,374.80 | 4.81 | 917,670.34 | 4.24 |
| Mamusha | 2,655,047.96 | 2,628,752.29 | 99.01 | 2,730,754.63 | 2,713,956.80 | 99.38 | 75,706.67 | 2.85 | 85,204.51 | 3.24 |
| Deçan | 14,778,314.61 | 14,613,840.81 | 98.89 | 15,066,891.08 | 15,009,612.07 | 99.62 | 288,576.47 | 1.95 | 395,771.26 | 2.71 |
| Gjakovë | 42,459,303.23 | 41,284,593.03 | 97.23 | 43,216,536.56 | 42,009,775.42 | 97.21 | 757,233.33 | 1.78 | 725,182.39 | 1.76 |
| Istog | 16,426,935.88 | 15,790,561.36 | 96.13 | 17,498,050.53 | 17,421,448.05 | 99.56 | 1,071,114.65 | 6.52 | 1,630,886.69 | 10.33 |
| Klinë | 15,746,410.59 | 15,346,178.50 | 97.46 | 16,947,073.30 | 16,554,775.35 | 97.69 | 1,200,662.71 | 7.62 | 1,208,596.85 | 7.88 |
| Pejë | 41,859,908.57 | 41,339,024.87 | 98.76 | 42,629,962.05 | 40,661,557.37 | 95.38 | 770,053.48 | 1.84 | (677,467.50) | (1.64) |
| Juniku | 2,374,083.16 | 2,218,402.69 | 93.44 | 2,542,647.24 | 2,451,784.86 | 96.43 | 168,564.08 | 7.10 | 233,382.17 | 10.52 |
| Leposaviq | 2,733,066.67 | 1,613,177.73 | 59.02 | 5,667,656.67 | 3,781,589.61 | 66.72 | 2,934,590.00 | 107.37 | 2,168,411.88 | 134.42 |
| Mitrovicë | 30,800,458.55 | 28,907,760.50 | 93.85 | 31,862,420.55 | 29,935,457.37 | 93.95 | 1,061,962.00 | 3.45 | 1,027,696.87 | 3.56 |
| Skenderaj | 20,500,264.77 | 20,340,451.42 | 99.22 | 20,855,881.71 | 20,600,859.28 | 98.78 | 355,616.94 | 1.73 | 260,407.86 | 1.28 |
| Vushtrri | 29,358,260.11 | 27,470,771.26 | 93.57 | 29,895,825.29 | 29,829,442.89 | 99.78 | 537,565.18 | 1.83 | 2,358,671.63 | 8.59 |
| Zubin Potok | 2,332,937.48 | 2,062,202.84 | 88.40 | 2,856,031.39 | 2,172,681.10 | 76.07 | 523,093.91 | 22.42 | 110,478.26 | 5.36 |
| Zveçan | 2,163,216.62 | 2,078,996.47 | 96.11 | 2,848,892.40 | 2,549,478.67 | 89.49 | 685,675.78 | 31.70 | 470,482.20 | 22.63 |
| Mitrovica Veriore | 2,718,630.53 | 2,440,605.70 | 89.77 | 6,145,662.74 | 3,285,044.48 | 53.45 | 3,427,032.21 | 126.06 | 844,438.78 | 34.60 |
| Gjilan | 41,235,959.96 | 39,252,593.23 | 95.19 | 41,341,681.20 | 39,354,278.98 | 95.19 | 105,721.24 | 0.26 | 101,685.75 | 0.26 |
| Kaçanik | 12,855,088.66 | 11,877,205.92 | 92.39 | 14,126,898.03 | 13,773,300.32 | 97.50 | 1,271,809.37 | 9.89 | 1,896,094.40 | 15.96 |
| Kamenicë | 16,995,289.82 | 15,682,872.30 | 92.28 | 15,969,091.35 | 15,591,005.06 | 97.63 | (1,026,198.47) | (6.04) | (91,867.24) | (0.59) |
| Novo Bërd | 4,266,737.24 | 4,205,132.50 | 98.56 | 4,749,353.94 | 4,572,915.98 | 96.29 | 482,616.70 | 11.31 | 367,783.48 | 8.75 |
| Shtërpcë | 4,769,578.26 | 4,313,962.06 | 90.45 | 4,887,719.35 | 4,503,450.67 | 92.14 | 118,141.09 | 2.48 | 189,488.61 | 4.39 |
| Ferizaj | 42,966,691.32 | 42,920,087.66 | 99.89 | 49,710,790.43 | 49,680,698.81 | 99.94 | 6,744,099.11 | 15.70 | 6,760,611.15 | 15.75 |
| Viti | 19,431,800.89 | 19,369,714.32 | 99.68 | 18,527,662.85 | 18,484,532.37 | 99.77 | (904,138.04) | (4.65) | (885,181.95) | (4.57) |
| Partesh | 1,642,990.31 | 1,628,443.87 | 99.11 | 1,882,098.62 | 1,833,901.34 | 97.44 | 239,108.31 | 14.55 | 205,457.47 | 12.62 |
| Hani I Elezit | 3,548,177.12 | 3,313,445.01 | 93.38 | 4,737,666.83 | 4,150,049.82 | 87.60 | 1,189,489.71 | 33.52 | 836,604.81 | 25.25 |
| Kllokot | 1,502,872.72 | 1,328,306.98 | 88.38 | 1,541,013.82 | 1,431,409.38 | 92.89 | 38,141.10 | 2.54 | 103,102.40 | 7.76 |
| Ranillugë | 2,347,289.67 | 2,116,053.88 | 90.15 | 2,730,610.91 | 2,432,725.92 | 89.09 | 383,321.24 | 16.33 | 316,672.04 | 14.97 |
| **TOTALI** | **841,040,645.99** | **784,532,455.39** | **93.28** | **864,227,543.13** | **837,642,279.69** | **96.92** | **23,186,897.14** | **2.76** | **53,109,824.30** | **6.77** |

*Shtojca nr.9 – % e realizimit të buxhetit.*




**Referencat:** Shënimet nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës-SIMFK nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve / Departamenti i Thesarit të datës 09.03-10.03.2026.

# RAPORT LIDHUR ME OPINIONET E AUDITIMIT PËR KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Bazuar në planin e punës për vitin 2025, Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik Lokal, MAPL, ka përgatitur edhe raportin lidhur me opinionet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për komuna të vitit 2024 dhe krahasimi me vitit 2023.

Raporti është bazuar në të dhënat e publikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit për komunat e Republikës së Kosovës për vitet 2024 dhe 2023.

Opinionet e auditorit për komuna janë të ndryshme sipas viteve:

- **Opinion i pamodifikuar:** Në vitin 2024 opinionin e pamodifikuar kanë pranuar 7 komuna, ndërsa në vitin 2023 këtë opinon kanë pranuar 15 komuna,

- **Opinion të kualifikuar:** Me opinion të kualifikuar në vitin 2024 janë 31 komuna, kurse në vitin 2023 janë 23 komuna.

Në vijim mund të shihni pasqyrën me të dhëna më të detajuara lidhur me këto opinione të Zyrës Kombëtare të Auditimit sipas komunave dhe sipas viteve.

*Shtojca nr.1 - Pasqyra e përgjithshme e opinioneve të Zyrës Kombëtare të Auditimit sipas komunave dhe sipas viteve 2023-2024;*

| Opinioni i auditorit | Vitet | Komunat |
|---|---|---|
| Opinion i pamodifikuar | **2023** | Skenderaj, Mamushë, Klinë, Kaçanik, Junik, Hani i Elezit, Dragash, Gllogoc, Suharekë, Shtërpcë, Prizren, Partesh, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Istog. (15) |
| | **2024** | Mamushë, Klinë, Kamenicë, Hani i Elezit, Dragash, Rahovec, Partesh(7) |
| Opinion i kualifikuar | **2023** | Viti, Malishevë, Kamenicë, Deçan, Rahovec, Obiliq, Vushtrri, Shtime, Ranillug, Podujevë, Pejë, Novobërdë, Kllokot, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Prishtinë, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok. (23) |
| | **2024** | Viti, Skenderaj, Malishevë, Kaçanik, Junik, Deçan, Gllogoc, Obiliq, Vushtrri, Suharekë, Shtime, Shtërpcë, Ranillug, Prizren, Podujevë, Pejë, Novoberdë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Kllokot, Istog, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Prishtinë, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok.(31) |

## GJETJET KRYESORE TË AUDITIMIT

Parregullsitë janë të përfshira në cikël të ndryshëm transaksionesh dhe kategorish ekonomike të ndërlidhura me menaxhim financiar të shpenzimeve, të hyrave, proceseve të prokurimit, subvencioneve, menaxhim të aseteve, menaxhim të personelit dhe fusha të tjera.
Në fushën e prokurimit publik gjetjet më të theksuara janë:

- Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore, procedimi i urdhër-blerjeve jo sipas rregullave financiare, përzgjedhja e operatorit ekonomik të pa përgjegjshëm, tejkalim i sasive në pozicionet e kontraktuara, mangësi në menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektorik të prokurimit, mangësitë në procesin e vlerësimit të ofertave, mangësi në procesin e menaxhimit të kontratave, nënshkrimi i kontratave në mungesë të buxhetit, mungesa e projekteve ekzekutuese, ndryshime në sasitë e para-masës pa aprovimet paraprake dhe vonesat në realizimin e punimeve, mungesa e sigurisë së ekzekutimit për kohëzgjatjen e kontratës dhe mungesa e garancionit bankar për kualitetin e punimeve.

Në fushën e shpenzimeve janë evidentuar gjetje të natyrës, si:

- Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, mungesa e regjistrimit të pasurive jo-financiare në regjistrin kontabël të pasurive, avanset e pa mbyllura nga vitet paraprake, vonesa në pagesën e detyrimeve, vonesa në realizimin e projekteve, mbivlerësim i pasurive financiare dhe jofinanciare dhe nënvlersimi pasurisë financiare dhe jo financiare, certifikim i pagesave në mungesë te raportit të menaxherit të projektit, pagesat përmes vendimeve gjyqësore, shpenzime të pa aprovuara dhe tejkalim i limiteve të lejuara, pagesa për punë që nuk janë kryer, mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve, mangësi në marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të komunës dhe Organizatave Joqeveritare, mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencione, subvencionim pa thirrje publike, mos protokollimi i faturave të pranuara.

Në fushën e të hyrave janë identifikuar gjetje kryesore, si:

- Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme / borxheve të vjetra, mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme, prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme, jo efikasitet në verifikimin e pronave komunale, vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore.

Në fushën e menaxhimit të personelit janë gjetur parregullsi, si:

- Emërtimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme, angazhimi i punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa respektuar procedurat e prokurimit publik dhe kryesisht për punë dhe detyra të rregullta të organizatës.

Rishikimi dhe harmonizmi i legjislacionit, integrimi i sistemeve në fushën e menaxhimit te parasë publike (SIMFK, PIP, E-pasuria, E-prokurimi etj), një qasje më e përkushtuar ndaj obligimeve dhe përgjegjësive ligjore, do të ndihmonte komunat të kenë mundësi të përmirësojnë menaxhimin e parasë publike, përmirësim të të gjeturave dhe adresim të rekomandimeve të pranuara nga Zyra Kombetare e Audimit

## REKOMANDIMET

- Dërgimi i listës së akteve të miratuara nga kryetarët e komunave, ashtu si është e përcaktuar në nenin 80.1 të LVL-së;
- Komunat të dërgojnë me kohë ftesat dhe materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendeve të komunave ashtu siç përcaktohet me nenin 43 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale.
- Kryetarët e komunave (Gjakovë, Gjilan, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq), të raportojnë për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës ashtu siç përcaktohet me nenin 58 të LVL-së;
- Kuvendet e komunave të bëjnë rishqyrtimin e akteve, ashtu siç përcaktohet në nenin 80.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të bëjnë rishqyrtimin e akteve të Komunave;
- Kuvendet e komunave të themelojnë Këshillat për Siguri në Bashkësi sipas Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë dhe Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB; Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB, Udhëzim Administrativ Nr. 03/2012 MAPL për KKSB;
- Komunat të cilat kanë themeluar KKSB-të, të ndërmarrin veprime konkrete dhe të mbajnë së paku 6 takime në vit konform udhëzimit administrativ.
- Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e hartimit dhe miratimit të akteve juridike nënligjore;
- Komunat ti dërgojnë për vlerësim të ligjshmërisë në MAPL, aktet e miratuara nga kuvendet e komunave ashtu siç përcaktohet me nenin 43.5, të LVL.
- Të hartohet Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në komunat: Dragash, Fushë Kosovë, Gllogoc, Gjakovë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë.
- Të hartohet Plani Lokal për Integritet në 5 komunat: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Zveçan,
- Të hartohet Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në komunat: Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Gllogoc, Hani i Elezit, Klinë, Lipjan, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë,
- Të themelohet komiteti për auditim të brendshme në Komunat: Hani i Elezit, Istog, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Zveçan,
- Të themelohen Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunat: Partesh; Prishtinë; Ranillug ,
- Të hartohet Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunat: Deçan; Fushë Kosovë; Gjilan; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Pejë; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë,
- Të hartohet Plani për Menaxhimin e tokave rurale në komunat: Deçan, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Gllogoc, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë

e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prizren, Rahovec, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë),

- Të hartohet Plani për Efiçiencës të Energjisë në komunat: Fushë Kosovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë,
- Të hartohet Strategjia dhe Plani të Veprimit kundër dhunës në komunat: Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë, Vushtrri, Zveçan,
- Të hartohet Plani tre-vjeçar për strehim Social në komunat: Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Hani i Elezit, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë,
- Të hartohet Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptian në komunat: Deçan, Fushë Kosovë, Gjilan, Istog, Kaçanik, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Prizren, Skenderaj, Viti, Zveçan,
- Të caktohet zyrtari që raporton për Planin Lokal të Integritetit në komunat: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë, Ranillug, Zveçan,
- Të caktohet zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës në komunat: Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Shtërpcë, Viti, Zveçan.
- Të ofrohet përkujdesje për fëmijët pa përkujdesje prindërore në Komunat: Dragash, Mamushë, Partesh, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Zveçan,
- Të themelohet Këshilli komunal apo mekanizmi për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në baza gjinore në komunat: Ferizaj, Mitrovicë e Jugut, Partesh, Zveçan, Kamenicë,
- Të funksionalizohet Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar në komunat: Deçan, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Ranillug, Shtërpcë, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë,
- Të themelohet Ekipi Vepruese për Siguri (EVS) në komunat: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Klinë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpcë, Skenderaj, Zveçan,
- Të themelohen Këshillat në Fshatra në komunat: Fushë Kosovë; Gjilan; Kaçanik; Mamushë; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Zveçan,
- Të organizohen fushata vetëdijësuese në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës në komunat: Hani i Elezit, Istog, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Shtërpcë, Skenderaj, Zveçan,
- Të themelohen Këshillat Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunat: Dragash; Hani i Elezit; Istog; Mamushë; Novobërdë; Rahovec; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Zveçan,
- Të ofrohet përkujdesje rezidenciale për të moshuarit në Komunat: Dragash; Gjilan; Kaçanik; Malishevë; Mamushë; Obiliq; Partesh; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtërpcë; Zveçan,
- Të themelohet komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian në komunat: Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj.